



REAGIMI



"150 MILIONË USD NGA OLIGARKËT". BASHA PROPOZON PLANIN EMERGJENT ME 3 PIKA...

Faqe 2

HISTORIA



SHTATË BALLË ISHTE TËRMETI, TETË BALLË UNITETI

52 vjet më parë - Tërmeti i fortë i 1967-ës, si u shkatëruan fshatrat e Dibrës

Faqe 5

LETERTSI



BESNIK MUSTAFAJ

DËMTUAR GJATË RRUGËS


NJË PALË OPINGA PËR HRUSHOVIN?!

HALIL RAMA

Faqe 10

Tërmet i fuqishëm i 26 nëntorit 2019, nuk kaloi pa pasoja edhe në qytetin e Bulqizës dhe fshatrat e kësaj bashkie

BULQIZA PERBALLE PASOJAVE TE TERMETIT



TË GJITHË ME DURRËSIN, ME TIRANËN, ME THUMANËN

NGA REXHEP QOSJA

1. Jemi të tronditur. Të gjithë. Jemi të tronditur, me shpirt e me mendje. Të gjithë. Të tronditur në këto ditë para e gjatës Ditës së madhe në historinë tonë. Ditës së Flamurit kombëtar e shpaljes së Shqipërisë shtet.

Të gjithë. Të tronditur për shkak të gjithë atyre viktimave, të gjithë atyre të plagosurve, të gjithë atyre traumave që nuk kalojnë lehtë e shpejtë, për shkak të gjithë atyre dëmeve të mëdha lëndore, ekonomike, shoqërore e kulturore.

Jemi të tronditur për shkak të tragjedive që pësuan nënët, fëmijët, vajzat e reja e djemtë e rinx, në lule të rinisë.

Tronditja e shkaktuar kësaj here prej tërmëtit të 26 nëntorit është tronditje që zgjat shumë. Dhe, zgjat shumë për shkak se pushton ndjenjat,

Faqe 11



- Fakti që për tërmëtin i 21 Shtatorit, dosjet janë ende nëpër bashki, tregon se sa indiferentizëm ka nga strukturat bashkiake të qarkut Dibër. Nëxhbedin Shehu, prefekti i Qarkut Dibër, thotë se ende nuk janë dërguar dosjet në Emergenat Civile

Fqinjët e familjes Lala me origjinë nga Dibra rrëfenjë tmerrin e tërmëtit **TRAGJEDI E PAPARË NË FAMILIJEN LALA**



Faqe 7

AKTUALITET

Faqe 6

SOLIDARITETI, SI TRIUMF MBI FATKEQËSINË E TËRMËTIT



REAGIMI

Faqe 8

Po na ikin nga Shqipëria njerëz me vlerë si Agron Tafa, dhe na kanë mbetur horrat e zuzarët

NGA AGRON GJEKMARKAJ

PROMOVIMI

Faqe 9

Sakip Cami promovon "LANÇ në Dibër"

Vepër dinjitoze në fondin e letërsisë sonë dokumentare

POEZI

Faqe 12

**Poezi nga Demir Rusi,
BARIE ÇUPI**

“150 milionë USD nga oligarkët”. BASHA PROPOZON PLANIN EMERGJENT ME 3 PIKA. “Vlerësimi i banesave mund të mbarojë për 10 ditë”

Pyetje: Zoti Basha si e vlerësoni situatën pas tërmetit?

LULZIM BASHA: Këtu ndodhemi në lagjen 7 të qytetit të Durrësit. Faktikisht, jemi në qendër të qytetit të Durrësit. Gjendja këtu është e mjerueshme.

Në radhë të parë, shumica e banorëve këtu nuk kanë marrë asnjë lloj ndihmë, siç i dëgjuat vetë një pjesë prej tyre, dhe unë i dëgjoja pothuajse të gjithë gjatë kohës që isha në lëvizje në lagje para se të mbërrin ju.

E dyta, ka një pasiguri, sepse njerëzit nuk e dine, nëse mund të rrinë apo nuk mund të rrinë brenda. Janë futur në disa prej banesave ku gjendja është e mjerueshme, kanë rënë muret, ka shkatërrim të oren-dive dhe banorët nuk kanë siguri do të rrinë apo nuk do të rrinë. Në qoftë se nuk rrinë, ku do të shkojnë. Disa prej banorëve thonë që u është siguruar një apo dy netë strehim dhe pastaj janë nxjerrë. Pra, këtu mbi-zotëron kaosi.

E rëndësishme është të kuptojmë se po mbushet java e ngjarjeve tragjike dhe prioritare është ndihmesa ndaj këtyre njerëzve në nevojë. Ne në radhë të parë mbështesim gjithçka, çdo masë që merret për t'i ndihmuar këta njerëz dhe po bëjmë çfarë të mundemi ne si opozitë për t'i ndihmuar, kryesish përmes vullnetarizmit tonë dhe mbështetësve tanë.

Tani është koha për veprime urgjente, konkrete dhe të mirëkoordinuara.

Siç e dini, mbrëmë kam patur një takim me ekspertët, inxhinierët, specialistët më të mirë që Shqipëria ka, duke përfshirë disa nga drejtuesit kryesorë të institucioneve më të mirë shkencorë dhe akademikë në vend. Nga ky takim kam mësuar se kemi të pakten 500 specialistë, kryesish inxhinierë, të gatshëm për të dhënë kontributin e tyre vullnetar. Nisur nga kjo dhe nisur nga gjendja që është alarmante, jo vetëm këtu në lagjen 7 por kudo, kam ardhur nga Bubqi, ku situata është totalisht jashtë kontrollit, propozoj një plan me tre pika:

Pika e parë, organizimi i këtyre 500 apo më shumë inxhinierëve në mënyrë vullnetare, siç janë ofruar nga qeveria për të përshpejtuar procesin e vlerësimit të banesave. Vlerësimi i banesave të banorëve u jep siguri, u jep qartësi dhe kjo pastaj kontribuon edhe për qetësimin shpirtëror dhe mendor të paktën në këtë fazë të dytë të traumës që po jetojmë. Pra, pika e parë është organizimi i këtyre qindra inxhinierëve të cilët ofrohen vullnetarisht për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.

1. Pika e parë, organizimi i këtyre 500 apo më shumë inxhinierëve në mënyrë vullnetare, siç janë ofruar nga qeveria për të përshpejtuar procesin e vlerësimit të banesave. Vlerësimi i banesave të banorëve u jep siguri, u jep qartësi dhe kjo pastaj kontribuon edhe për qetësimin shpirtëror dhe mendor të paktën në këtë fazë të dytë të traumës që po jetojmë. Pra, pika e parë është organizimi i këtyre qindra inxhinierëve të cilët ofrohen vullnetarisht për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.

2. E dyta, vlerësimi i me urgjencë dhe ndarja në dy kategori kryesore: të banueshme dhe të pabanueshme, që banorët të kenë qartësi se çfarë do të bëjnë, të rrinë aty apo jo.

3. Dhe pika e tretë e propozimit është të përdoren fuqitë që ka qeveria në gjendjen e fatkeqësisë natyrore për të anulluar afro 150 milionë dollarë të planifikuara për 10 oligarkë. 150 milionë dollarë të destinohen urgjentisht për t'u ardhur në ndihmë banorëve në nevojë.

dhe ndarja në dy kategori kryesore: të banueshme dhe të pabanueshme, që banorët të kenë qartësi se çfarë do të bëjnë, të rrinë aty apo jo.

Dhe pika e tretë e propozimit është të përdoren fuqitë që ka qeveria në gjendjen e fatkeqësisë natyrore për të anulluar afro 150 milionë dollarë të planifikuara për 10 oligarkë. 150 milionë dollarë të destinohen urgjentisht për t'u ardhur në ndihmë banorëve në nevojë.

Pra, pika e parë është organizimi i këtyre qindra inxhinierëve të cilët ofrohen vullnetarisht për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.

E dyta, vlerësimi i me urgjencë



jnë për t'i zhvilluar edhe më tej.

Së pari le të përfitojmë nga kjo ofertë vullnetarizmi i inxhinierëve shqiptarë për të shtuar grupet në terren. Problemi dhe ankthi kryesor është se askush nuk vjen të shohë e t'u thotë, këtu mund të rrini ose jo, dhe kjo është çështje vlerësimi. Këtë mund ta bëjë qeveria dhe askush tjetër. Këtë duhet ta bëjë shteti. Të merren 500 a më shumë inxhinierë që janë vetëofruar, të organizohen në grupe pune dhe të shtrihen në të gjithë zonën e dëmtuar.

Së dyti të bëhet urgjentisht vlerësimi sipas ekspertëve me të cilët bashkëbisedova mbrëmë, me angazhimin e këtyre 500 inxhinierëve mund të mbarojë brenda një kohe të shkurtër. Dikush tha një javë, por maksimumi 10 ditë.

Dhe së terti, të përdoren fuqitë e jashtëzakonshme që qeveria ka në kuadrin e fatkeqësisë natyrore për të anulluar kontratat e këtyre 10 oligarkëve. Bëhet fjalë për një shumë të madhe rreth 150 milionë dollarë të planifikuara në buxhet. Këto para urgjentisht të destinohen për t'u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë.

Ky është plani me tre pika të cilin ia vë në dispozicion qeverisë për ta zbatuar.

Pyetje: Zoti Basha, folët për një plan me tre pika, por në fakt kryeministri Edi Rama shpesh ju ka ftuar për një bashkëpunim që, në fakt, është për të mirën e këtyre qytetarëve që ju komunikuar vetëm pak minuta më parë. A do t'i përgjigjeni ftesës së kryeministrit Edi Rama, zoti Basha?

LULZIM BASHA: Gjendja tragjike e këtyre njerëzve kërkon ndihmë konkrete, nuk kërkon poza dhe as teatër. Kërkon angazhim konkret. Prandaj, në emër të opozitës, mbështesim çdo përpjekje që u vjen në ndihmë këtyre njerëzve në nevojë dhe, nga ana tjetër, po bëjmë ne çfarë kemi në dorë si opozitë, për t'i

ndihmuar, përmes vullnetarizmit dhe mbështetsve tanë. Tani nuk është koha as për shfaqje, as për fotografi, as për teatër.

Pyetje: Këtë përpjekje do ta mbështesni?

LULZIM BASHA: Sapo jua thashë. Po e përsëris për herë të kartërt. Mbështesim çdo përpjekje për t'u ardhur në ndihmë këtyre njerëzve. Këta njerëz kanë nevojë për ndihmë.

Së pari, PD, opozita e bashkuar mbështet çdo përpjekje të qeverisë dhe të çdokujt tjetër për t'u ardhur në ndihmë këtyre njerëzve.

Së dyti, po bëjmë dhe do të vazhdojmë të bëjmë çfarë kemi ne në dorë për të ndihmuar, përmes vullnetarizmit tonë dhe të mbështetësve tanë. Edhe një herë po ju them, nuk është koha për foto dhe për shfaqje. Tani është koha për veprime të mirëkoordinuara urgjente: Që të vlerësohet gjendja e banesave, të sigurohen njerëzit, që të garantohet siguria e tyre dhe pastaj t'u garantohet strehimi. Në funksion të kësaj është plani ynë trepikësh.

1. Të përdorim kapacitetet më të mira që kemi. Këta 500 apo më shumë inxhinierë në mënyrë vullnetare po i afrojnë këto kapacitete. Thirrja ime ndaj qeverisë, ndaj kryeministrit, ndaj grupit që koordinon emergjencën është që menjëherë ta zgjerojë grupin e punës që merret me vlerësimin e banesave. Me 500 më shumë do të thotë që mund të veprohet më shpejt në terren.

2. Të bëhet një vlerësim brenda një kohe sa më të shkurtër.

3. Të pezullohen dhe anullohen menjëherë kontratat e këtyre 10 oligarkëve, afro 150 milionë dollar para në buxhet dhe këto para menjëherë të destinohen për të ndihmuar banorët.

Ky është propozimi ynë me 3 pika, që do të detajohet akoma më shumë në ditët që vijnë.

Tërmet i fuqishëm i 26 nëntorit 2019, nuk kaloi pa pasoja edhe në qytetin e Bulqizës dhe fshatrat e kësaj bashkie

BULQIZA PËRBALLË PASOJAVE TË TËRMETIT



- Fakti që për tërmetin i 21 Shtatorit, dosjet janë ende nëpër bashki, tregon se sa indiferentizëm ka nga strukturat bashkiakë të qarkut Dibër. Nëxbedin Shehu, prefekti i Qarkut Dibër, thotë se ende nuk janë dërguar dosjet në Emergjencat Civile*

Tërmet i fuqishëm i 26 nëntorit 2019, nuk kaloi pa pasoja edhe në qytetin e Bulqizës dhe fshatrat e kësaj bashkie.

Një pallat në lagjen e Re te qytetit te Bulqize krijuar çarje të forta ku po rrezikon jetën e familjeve që jetojnë në të. Sipas banorëve shkak i çarjes së pallatit erdhi edhe si rezultat i tërmetit të fundit që përfshiu gjithë Shqipërinë por nuk ka munguar edhe rreshqitja e tokës. Banorët shprehen se ndjehemi mjaft të rrezikuar dhe se plasaritjet e para kanë filluar që para një viti po flejmë me frikë, kërkojmë të marren masat nga ana e instacave përkatëse para se të ndodhë ndonjë tragjedi nga shembja e pallatit. Në lidhje me situatën e krijuar në Bashkinë e Bulqizës po e ndjek nga afër dhe po nxjerr detyrat përkatëse të bashkisë, kryetari i Bashkise Lefter Alla, i cili

pasi pasi u njoh me gjendjen e krijuar pas tërmetit, veçanërisht në dëmtimet në banesa familiar në shkolla, objekte sociale dhe infrastrukturë, u identifikuani dëmtimet dhe nevojat energjente ku duhet të ndërhyrë pa vonesë, hartoij një plan të detajuar veprimi dhe garantoi familjaret që do të mundësojë gjetjen e shtëpisë me qera ku do të paguhën nga ana e bashkisë.

Gjendja e ankthit dhe shqetësimi pas tërmetit po vjen gradualisht në rënien dhejeta në bashkinë e Bulqizës po shkon drejt normalitetit. Pasojat e tërmetit do të shërbejnë një mësim për të ardhmen për të genë më të përgatitur për të përbaluar në kohë dhe me efikasitet fatkeqësi të tillë natyrore.



EDHE KUR E PËSOJMË, NUK MËSOJMË, DHE NUK REAGOJMË ME EFIÇENCË

Fakti që për tërmetin i 21 Shtatorit, dosjet janë ende nëpër bashki, tregon se sa indiferentizëm ka nga strukturat bashkiakë të qarkut Dibër. Nëxbedin Shehu, prefekti i Qarkut Dibër, thotë se ende nuk janë dërguar dosjet në Emergjencat Civile.

Në Drejtorinë e Emergjencave Civile në Tiranë ende nuk kanë mbërritur emrat e familjarëve të dëmtuar nga tërmeti i 21 shtatorit.

Dosjet e banesave të dëmtuara nga tërmeti i 21 Shtatorit ende nuk janë plotësuar nga disa bashki në Qarkun e Dibrës. Prefekti i këtij Qarku Nëxbedin Shehu, tha se bashkitë Mat, Klos e Bulqizë kanë dorëzuar vendimet e marra në këshillat bashkiak për listën emërore të dëmeve, ndërsa Bashkia Dibër nuk ka dorëzuar ende. Nga ana tjeter prefekti Shehu tha se pret edhe dosjet për secilin nga personat e dëmtuar në tërmetin e 21 Shtatorit, e vetëm pasi të janë verifikuar të gjitha do të dërgohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Tiranë. Tërmeti i 21 Shtatorit dëmet më të mëdha i shkaktoi në Bashkinë e Klosit, kryesisht në anën jugore të tij për shkak edhe të afersisë me epigendrën që e kishte në detin Adriatik. Qëndrimet burokratike dhe inefiqësive të administratës së Bashkive të qarkut Dibrës po sjellin zvarritje të këtij problem dhe shqetësimi social.

BASHKIA BULQIZË NË NDIHMË TË BANORËVE TË PREKUR NGA TËRMETI

Si kudo në vendin tonë që po sensibilizohet opinioni kambëtar dhe ndërkombëtar ndaj dëmeve që shkakoi tërmeti i 26 nëntorit 2019, edhe qytetarët e e bashkisë Bulqizë po reflektojnë me humanizmin e tyre duke dhueuar sipas mundësive të tyre ekonomike. Ky solidaritet vëllazëror tregon se shqiptarët kanë të ngulitur thellë ndjenjën e humanizmit dhe të ndihmës në rast emergjencë. Një organizim të tillë e ka filluar dhe drejtuar vetë kryetari i bashkisë, Lefter Alla. Pasi ka mbajtur një minutë heshtje në nderim të viktimateve të tërmetit që goditi Shqipërinë, kryetari i Bashkisë Bulqizë Lefter Alla ka mbledhur Shabin e Emergjencave Civile pranë Bashkisë si dhe drejtuesit e institucioneve ku ka kërkuar që të bëhet sensibilizimi për t'ju ardhur në ndihmë banorëve të prekur nga tërmeti. Në këtë kuadër në qendër të qytetit të Bulqizës është ngritur një stendë për t'ju dhënë një mundësi banorëve, kompanieve private, bizneseve për të sjellë ndhama në ushqime veshmbathje dhe para kesh sipas mundësive të tyre. Per t'u ardhur në ndihmë sadopak banorëve të prekur nga tërmeti edhe disa institucione u shprehën të gateshëm për ndihmë për këto banorë. Ndërkohë kreu i Bashkisë Lefter Alla bëri thirrje bizneseve të Bulqizës si dhe kompanive të kromit që të kontribojnë për situatën e krijuar tek banorët e prekur nga tërmeti. Edhe në Bulqizë ka mjaft familje të varfëra që mezi e përballojnë jetën në kushte normale. Dhe në rastin e dëmtimit të shtëpisë të tyre, Bashkia është fokusuar t'u lehtësojë vuajtjen dhe të kapërcejnjë me dinjitet situatën e rëndë që po kalojmë. Është për t'u falenderuar komuniteti i Bulqizës dhe gjithë faktorët ekonomikë që po jepin ndihmë konkrete me materiale dhe vlerë monetare.



LINJA E ENERGJISË ELEKTRIKE RREZIKON FAMILJARËT

Familja Previzi nga Sopoti i Bulqizës, apelon ndaj OSHEE-së.

Problemet sociale dhe vështirësitet e jetës së banorëve të Bulqizës shfaqen në forma nga më të ndryshmet. Jo rrallë herë shqetësim janë bërë dhe rreziqet që vijnë për shkak të infrastrukturës së rrjetit të energjisë elektrike. Linjat e energjisë elektrike që kalonjë pranë banesave përbëjnë një rezik që duhet patur në konsideratë. Shembull konkret për këtë që thamë më sipër është familja e Subi Previzit nga fshati Zall-Sopot i Zerqanit në Bashkinë e Bulqizës, e cila po rrezikohet nga linja e energjisë elektrike të cilën e ka pak metra larg banesës. Për të evituar këtë rrezik nuk duhet ndonjë investim i madh. Në mungesë të një shtyllë të posaçshme, telat përcjellës janë vendosur në një pemë arrë. Por familjarët tregojnë se sa herë ka reshje shirash apo fryn erë, linja shpërthen në flake, si pasojë e kontaktit të telave me degët e pemës. Kjo ka bërë që fëmijët të rrezikohen pasi pas shkëndijës, telat këputen e mbeten në tokë. Po ashtu, familja Previzi qëndron me ditë të tëra pa energji elektrike në banesë deri kur elektriçistët të rilidhin telat. Ata shprehen se OSHEE Bulqizë i ka kërkuar familjes ta blejë vetë ajo shtyllën, duke mos pranuar që ta sjellin ata. Familja Previzi kërkon ndërhyjen e menjëhershme të OSHEE në mënyrë që të shmanget ndonjë tragjedi e mundshme. Rreziku është prezent për këtë familje ashtu siç vazhdon indiferenca e OSHEE të Qarkut Dibër.

Në histori janë regjistruar tërmete të forta që kanë shkatërruar qindra banesa e kanë marrë qindra jetë njerëzish

speciale

10 tërmetet më të fuqishme në historinë e Shqipërisë

Në histori janë regjistruar tërmete të forta që kanë shkatërruar qindra banesa e kanë marrë qindra jetë njerëzish. Shqipëria bën pjesë në zonën sismogjene Jonike-Adriatike, rajoni i Shkodrës; Shqipëria perëndimore; zona Korçë-Ohër-Peshkopi, me vija aktive në Lushnje, Elbasan, Dibër dhe Vlorë, Tepelenë-Ersekë.

Tërmeti prej 6.4 ballë që ra mëngjesin e 26 Nëntorit 2019, shkaktoi jo vetëm panik, por edhe të plagosur dhe viktimate.

Edhe në 21 shtator, një tërmet prej 5.8 ballë goditi Shqipërinë, fatmirësisht pati vetëm dëme materiale.

POR CILA ËSHTË HISTORIA E TËRMETEVE NË SHQIPËRI?

Në histori janë regjistruar tërmete të forta që kanë shkatërruar qindra banesa e kanë marrë qindra jetë njerëzish. Shqipëria bën pjesë në zonën sismogjene Jonike-Adriatike, rajoni i Shkodrës; Shqipëria perëndimore; zona Korçë-Ohër-Peshkopi, me vija aktive në Lushnje, Elbasan, Dibër dhe Vlorë, Tepelenë-Ersekë.

Alpet e Shqipërisë janë më pak të prekura nga lëkundjet e tërmeteve. Afërsisht, çdo vit në Shqipëri shkaktohen 4-5 tërmete me 6 ballë dhe çdo 25 vjet shkaktohet 1 tërmet me afro 9 ballë, duke e bërë kështu Shqipërinë një rajon me aktivitet të lartë sizmik.

Nga lashtësia njihen si tërmete më të fuqishme ai i Apolonisë në vitin 217 e.s., në Durrës në vitet 334 dhe 506 të erës sonë, si dhe në vitin 1273.

Gjithashu në kohët e vjetra përmenden dhe tërmetet e Butrintit në vitin 1153 dhe të Krujës në vitin 1617.

Nga studimet e pakta që kanë ardhur deri në ditët tona rezulton se gjatë shekullit te 19-të në Shqipëri janë ndjerë 77 tërmete me mbi 7 ballë.

Cilët janë 10 tërmetet më të fuqishmë në historinë e re të vendit tonë?

Historia nis së paku në vitin 1851...



17 tetor 1851

Rajoni i Beratit goditet nga një tërmet i fuqishëm me pasoja të rënda. Mbi 400 të vdekur dhe shkatërrime të shumta në ndërtesa. Plasaritje të mëdha, rrëshqitje toke dhe pluhur me squfur.

Korrik-gusht 1855

Shkodra ndjen lëkundje të forta që shkaktojnë shkatërrimin e Bushatit, Jubanit, Kozmaçit, Vaut të Dejës dhe fshatra të tjera në Shkodër, Karme, Dushan, Toplane dhe Bruç. çarje të mëdha në tokë.

22 dhjetor 1919

Leskovik-Konicë ndihet tërmeti 6.1 ballë i shkallës Rijter. Shumë shtëpi të shkatërruara në kufijtë shqiptarë si dhe në fshatrat grekë Isboros, Plavoli, Belthonsi dhe Kapaztiko. I gjithë rajoni i shkatërruar. Nuk ka të dhëna për viktima.

18 dhjetor 1920

Elbasanit i shkatërrohen totalisht

173 shtëpi dhe dhjetëra persona plagosë. Pasojat e tërmetit me epikendër në Elbasan më së shumti u ndjenë në Peqin ku 14 persona humbën jetën dhe 300 të tjera u plagosën rëndë.

30 mars 1921

Nuk ka të dhëna për dëme në njerëz, por dhjetëra shtëpi janë shkatërruar në Peshkopi dhe Dibër.

27 gusht 1948

Nën Shkodra preket nga tërmeti 5.5 ballë. Dëmtimi serioze të shtratit të lumit Buna dhe në qytetin e Shkodrës. Dëmet më të mëdha raportohen në Trush (1 i vdekur dhe 27 të plagosur). Shkatërrime objektesh ka pasur edhe në Oblike e Barbullush.

1 shtator 1959

Shkatërrime në Lushnjë, Fier, Rrogozhinë, Peqin, Kuçovë dhe Berat. Në total 944 shtëpi të shkatërruara, shkruan Javanës. Kryesisht

në Karbunarë të Lushnjës. Dëmtimi të mëdha në objekte industriale, shkolla, spitale dhe objektet kulturore. çarje të tokave bujqësore.

30 nëntor 1967

Librazhd-Dibër, 6.6 ballë. Dëme të mëdha në 13 lokalitete dhe 177 fshatra. Së bashku me Maqedoninë e prekur nga tërmet, raportohen 6,336 ndërtesa të shkatërruara. Raportohet për 12 të vdekur dhe 174 të plagosur.

15 prill 1979

Tërmeti 8 ballë godet Shkodrën duke shkaktuar viktima dhe dëmtim të mëdha. Fatkeqësish 40 persona humbën jetën në Shkodër-Lezhë. U dëmtuan 17 118 shtëpi e objekte social-kulturore.

9 janar 1988

Lëkundje të shpeshta në Tiranë me dëme materiale. Pasojat kryesore në fshatrat Arbanë dhe Petrelë.



Shtatë ballë ishte tërmeti, tetë ballë uniteti



GËZIM LLOJDIA

Pesëdhjetedy vjet më parë, më 30 Nëntor 1967, një tërmet i fuqishëm dëmtoi rëndë, rrëthin e Dibrës dhe të Librazhdit, ku shkatërrroi 177 fshatra. Si pasojë 12 persona humbën jetën dhe 174 të tjerë u plagosën. Ai cilësohet si tërmeti më i fortë dhe më shkatërrues në Shqipëri, duke shënuar plot 6.6 ballë. Ndodhi 51 vjet më parë, më 30 nëntor 1967 në zonën Librazhd-Dibër. Toka ishte çarë me gjatësi mbi 10 kilometra e zhvendosje vertikale të dheut deri në 50 centimetra.

1.

Mediumi i kohës ka dhënë këtë njofim për tërmetin e vitit 1967. Tërmeti i rëndë i ndodhur në 30 nëntor të vitit 1967, në prag dimri në kushte të vështira atmosferike në zonat verilindore të vendit. Çfarë ngjau dhe cila ishte dinamika e atij dimri te egër? Komiteti Qendror dhe Këshilli i Ministrave fillimisht u dërguan një telegram popullsisë së rretheve: Dibër dhe Librazhd. Në dt. 1 dhjetor 1967, Këshilli i Ministrave mori një vendim për të ndihmuar urgjentisht këto rrethe në mënyrë, që Brenda një muaji të zhduken pasojat e tërmetit.

Për këtë qëllim u ngrit edhe një komision shtetëror, njofton media E KOHES.. Mediumi "Drita" e 3 dhjetorit përcjell këtë njoftim: "Për të hetuar gjendjen në rrëthin e Peshkopisë shkuan Kryetari i kuvendit Haxhi Lleshi, zv.kryeministri Haki Toska, ministri Kadri Hazbiu, si dhe dy zv. ministra Shinasi Dragoti dhe Vera Ngjela. Qeveria e asaj kohë angazhoi si gjithmonë vullnetarët. Menjëherë në të dy rrethet u dërguan 255 specialistë nga ndërmarrjet e ndërtimit u dërguan në zonat e prekura nga tërmeti: 523 mijë tjegulla, 300 çadra, 1200 m² pupullit. Vullnetarët e parë ishin: 100 të rinj dhe të reja nga ndërmarrjet e Elbasanit dhe Cërrikut. Në Vlorë u krijua një brigadë me 250 punëtorë dhe specialistë që do të dërgoheshin në të dy rrethet veriore. Nga kryeqyteti u dërguan 300 specialistë dhe mjete.

2.

Ajo që thekson mediumi i kohës është fryma e lartë e entuziazmit

të njerëzve e diktaur nga partia në pushtet. Në mes të dhjetorit dy drejtuesit e shtetit komunist Enver Hoxha



dhe Mehmet Shehu nisen për në fshatrat e dëmtuara nga tërmeti. Në fshatin Vojnik të Peshkopisë mësohet se riparimi shtëpive kishte ecur me ritme të larta ndërkaq që koha dhe dimri i ftohtë me tufan e dëborë kishte vijuar çdo ditë të asaj beteje. Malësorët e befasuar nga vajtja e udhëheqëseve të shtetit janë shprehur sipas shtypit kështu: Nuk na e priste mendja që në këtë dimër kaq të ftohtë të na vinte një ndihme e tillë e madhe. Kemi edhe këtë lajm nga gazeta e shkrimitarëve sipas korrespondentit Aleks Çaqi: "Udhëheqësite shtetit komunist hyjnë në shtëpitë e reja të ndërtuara. I zoti i shtëpisë Barjam Muçaj i priti mysfirët me fjalët e zjarrta për Partinë që kujdeset aq shpejt për të shëruar plagët e tërmetit. Në fshatin Burim udhëheqësit e shtetit komunist vizituan shtëpinë e Halim Pikut, ku tërmeti i rrëzoit krejt shtëpinë dhe i vranët 8-vjeçar. Shtëpia e tij u ndërtuara nga vullnetarët brenda 7 ditëve. E. Hoxha i thotë Halim Pikut: "U bëftë kyç e liga!"

3.

POETI LLAZAR SILIQI SHKROI KËTO VARGJE PËR TËRMETIN.

Në trupin e atdheut na dhëmb çdo plagë
Tërmet
U trand Librazhd e Dibra.
Gërmadhë e sheh burri shtang shtëpinë e vet,
Në shkollë-pluhur rrënojash përmbi libra.
Përbindëshi i drodh në thellësitetë e tokës.
të vramë e të gjyntuam si në betejë

Por di shqiptari kryet në kor kob ta ngrëjë

Shtrihen gjithçka drejt tij

Duar shokësh....

Poeti i mirënjohur Fatos Arapi shkruan një poemë të titulluar: "Nëpër tërmete" Thellë dragoi i nëndheshëm lëviz

Nën këmbët tonë na ikën

Thua fluturon në erë.

Shih!

Hëna si portollamba në dhomë

Lëkundet e shtrembëron në qiell

Bosht i kurrit zë tokës thyhet, Frikë

Tmerr

Toka tërë plagë, plagë,

Kafshuar në qafë e në kuriz

Qielli, Çati e dyer nga të katër anët hapur

Shtëpi, katandi, gërmadha të kësaj dite të akullt

SHKRIMTARI PETRO MARKO REPORTAZH PËR SHOFERËT.. V. Q REPORTAZH NË RRUGËT E DIBRËS ZHURMOJNË MAKINA.....

Kënga që aso kohe morri dhënë ishte: Shtatë ballë ishte tërmeti, tetë ballë ishte uniteti.

A MPOSHTEN TËRMETET? NJË LIBËR, NJË HISTORI DHE DISA FOTO TË RRALLA

Ai cilësohet si tërmeti më i fortë dhe më shkatërrues në Shqipëri. Ndodhi më 30 nëntor 1967 në zonën Librazhd-Dibër.

6.6 ballë sipas shkallës Rihter, shkatërrroi 177 fshatra, ku humbën jetën 12 vetë dhe 177 të tjerë u plagosën. Toka u çà në një gjatësi mbi 10 kilometra e pati zhvendosje të dheut deri në 50 centimetra...

Unë nuk e jetova dridhjen. I ndodhur larg Dibre për pushimet e festave kohëkundja e madhe më gjeti ulur në ndjenjësen e autobusit diku mes Fushe-Krujës e Laçit.

Por jetova vrullin e jashtëzakonshëm për mposhtjen e pasojave të tërmetit,



Vetëm një gjysmë shkolle paska mbetur në këmbë

Fëmijët të fillojnë mësimin

"a...b...c"

Nën këmbët tuaja tërmete.

Posi fillon ajo kënga e Nazmiut

Ky popull me huqe

Këmishën e zezë ta bëka të kuqe...

a b c - në këmbët tuaja tërmete

Po ju s'po lexoni keq fëmijë...

solidaritetin e paparë ndonjëherë për të ndihmuar, solidaritet nga Jugu në Verë e nga Lindja në Perëndim.

Kam jetuar kudondodhjen e njerëzve kur dikujt i digjë shtëpia dhe lagija, fshati... nën një traditë të marrë brez pas brezi, në ditë betejash kundër pushtuesish, i vinte çatinë e i dorëzonte çelësat brenda javës.


Të nesërmend do të zgjohesha herët për të qenë pjesë e një marshimi tri orësh nga Peshkopia në Vojnikë të Maqellarës së bashku me nxënësit e Shkollës së Mesme "Nazmi Rushiti" ku isha pedagog i lëndëve teknike.

Një odise udhëtimi nga Tirana në Peshkopi, në dimrin e ashpër me dëborë e suferinë, dy netë në ndjenjësen e ngushtë të autobusit, tre ditë udhëtim nën një kujdes të jashtëzakonshëm që asgjë e keqe të mos na ndodhë, një shkrim i atyre ditëve në "Zërin e rinisë" flenë dhe zgjohen sa herë më vjen në kujtesë ajo fletë e historisë kur e gjithë Shqipëria u bë NJË me Dibrën.

Por a mposhten Tërmetet?

Për Hajri Hoxhën ish - kryetar i Komitetit Ekzekutiv dhe ish kryetar i Shtabit për Eliminimin e Pasojave të Tërmetit të 30 nëntorit 1967 në Dibrë: "Edhe tërmetet mposhten".

Këtë ai e ka shprehur në një libër me këtë titull duke përcjellë përvojën e popullit të Dibrës në ditët tepër të vështira të dhjetorit 1967, solidaritetin e madh të të gjithë popullit shqiptar i cili iu ndodh pranë dibranëve pa ungris mbrëmja e 30 nëntorit.



Fatkeqësia në humbjen e njerëzve të pafajshëm dhe dëme të pallogaritshme materiale, ka thirrur në kauzë qeverinë, shoqërinë civile, opozitën, vendet mike

aktualitet

SOLIDARITETI, SI TRIUMF MBI FATKEQËSINË E TËRMËTIT

• Tërmeti ndodhi, shkaktoi katastrofën më të madhe të gjysmëshekullit të fundit dhe Shqipëria mori atë që kishte bërë në këto 29 vjet: kaos, çoroditje, antishtet, papërgjegjshmëri dhe abuzim. 51 të vdekur dhe afro 1 mijë të plagosur eshtë një nga bilancet më të rënda të shkaktuar në një katastrofë natyrore në historinë e shtetit shqiptar

Goditja e befasishme e tërmëtit ishte një shok social, një befasë çoroditëse ne natën e 26 janarit 2019. Një nga qytetet më të bukurë, me një pozicion strategjik, Durrësi është prekur disa herë nga tërmëteti e fuqishme gjatë historisë dhe një histori që harrohet ka tendencën të përsëritet. Sot, Durrësi, i dyti pas Tiranës për përqendrimin e popullsisë, është qyteti më i betonizuar i vendit, në një terren ku toka nuk i përgjigjet makutërisë së ndërtimit. Përballimi i pasojave të tërmëtit është kryesfala e ditës në këtë fundnëntori. Fatkeqësia në humbjen e njerëzve të pafajshëm dhe dëme të pallogaritshme materiale, ka thirrur në kauzë qeverinë, shoqërinë civile, opozitën, vendet mike. Shqetësimi kryesor është si të kalohet kjo katastrofë natyrore që plakosi Shqipërinë e në mënyrë të veçantë Durrësin, Thumanën, Vorën dhe Tiranën, si të shpëtohen sa më shumë jetë të rrezikuara, si të shmangen sa të jetë e mundur tragedji të tjera, si të ndihmohen të pastrehët dhe të shokuarit, si të rifillojnë jetën qytetet dhe qytezat e mbërthyera nga frika. Tërmët i fuqishëm që nuk do të harrohet kurrë për shkak të bilancit të viktimitave dhe dëmeve të tjera. Si një përbindësh, goditi kur njerëzit ishin në gjumë. Për pak sekonda, disa ndërtesa në Durrës dhe Thumanë u shembën, dhjetëra njerëz përfunduan në rrënoja si në një apokalips, qindra të tjerë u lënduan, një numër i madh pallatesh e baneshash u bënë të pabanueshme. Natyra bën të sajën, fatkeqësia natyrore duhet t'i përgjigjemi në mbrojtjen tonë. Reflektojmë si e kemi kryer kete detyrë dhe çfarë u përket negligencave, papërgjegjshmërvive, gabimet janë njerëzore, grykësia babëzia njerëzore mungesa e shtetit e arsues tonë humane...dhe tani bëjmë blanicin e dëmeve. Disa pallate dhe disa hotele në brezit turistik të Durrësit u shembën si të ishin prej kartoni dhe vranë njerëz të pafajshëm. Sikur të ishin ndërtuar brenda parametrave të cilësisë dhe sigurisë së zëmra nuk do të ishin shembur. E njëjtë gjë me pallatet e pabanueshëm në gjendje të amortizuara në Durrësin e burkur që krenoheshim me të, si vitrinë të Adriatikut. Lakkia për dy lekë më shumë e atyre që i projektuan, i financuan, i ndërtuan, i menaxhuan, i shiten - lëkmi që na kushtoi shumë, me jetë njerëzish. Natyrisht ky pësim do bëhet mësim për të ardhmen tonë. Tash na mbetet vetëm solidaritet dhe dashuri vilazërore për të dëmtuarit nga tërmëti. Fatmirësish shumë pallate të rinj në Tiranë dhe në Durrës, Laç dhe Lezhë u qëndruam goditjeve. Nuk e kishim këtë verifikim. Së paku për një termet të magnitudës 6,4 të shkallës Rihter. Dhe gjithë sa jemi banorë në këto qytete më shumë se një milion- dhe bashkatdhatarët tanë brenda dhe jashtë vendit kemi falënderuar këto ditë me dorë në zemër arkitektët, inxhinierët, sismologët, ndërtuesit dhe sipërmarrësit privatë që respektuan parametrat në standartet e ndërtimit. Po nga ana tjetër, tërmëti i 26 nëntorit fshiu vuri buzë greminës gjithçka që nuk i rezistoi provës dhe mbollë vdekje e lëndime më shumë se paraardhësit e njëqind viteve të fundit. Kjo ishte hakmarria e ligjësive. Ky është çmimi i lartë që paguan familjet e goditura dhe mbarë vendi. Kryeministri Edi Rama vijon takimet me banorët e prekur nga tërmëti i fuqishëm i 26 nëntorit, që la pas 51 viktima, qindra të plagosur dhe mijëra banesa të rrënuara. Sensibilitëm i parë kombëtarë e ndërkombëtarë. U shpall gjendja e jashtëzakonëshme në Durrës, Tiranë, Lezhë. Fillon sistemi i të dëmtuarve në hotele. Ndiham me ushqime dhe veshje arrinjë nga të katër anët nga Kosova dhe Fqinjët. Shpërbllimi i viktimateve dhe strehimi i mijera qutetarëve tashmë është



sfida e qeverisë. Aftësia ripërtëritëse e shtetit është në provë. Komuniteti shoqëror shqiptar e dha provën e tij. Ishte një humanizëm dhe përkushtim shembullor. Çdo qytetar i dëmtuar nga pasojat e tërmëtit apo që ka humbur familjarë ka të drejtën e kërkimit të shpërbimit të të gjitha dëmeve pasurore dhe jopasurore (shëndeti, moral, ekzistencial). Shteti duhet të ngrihet në nivelin e përgjegjësisë së tij dhe të mos mjaftohet vetëm me solidaritetin. Kërcënimet ndaj mediave apo ndërtuesve sot, nuk kanë ndonjë vlerë për momentin, sepse këto janë detyra të drejtësise, por të mirëpritura do të ishin vendimet që ngjallin siguri, shpresë dhe detyrim për çdo individ, kompani që të mbajë barrën që i takon në shtet në një situatë të jashtëzakonshme si kjo.

STABILIZIMI I FAMILJEVE TË DËMTUARA, SI DO TRAJTOHEN NGA QEVERIA

Kryeministri Edi Rama, në mbledhjet e jashtëzakonshme të qeverisë për situatën post tërmëti, ka theksuar se ka filluar identifikimi i apartamenteve që do të merren me qira nga shteti, në të cilët do të qëndrojnë ata që nuk kthehen në banesa pasi janë të dëmtuara teresisht. Të gjithë qytetaret, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmëti dhe që aktualisht janë akomoduar nëpër hotele do të duhet të përgatiten që Krishtlindjet dhe Vitin e ri t'i kalojnë në këto hotele. Pas kësaj, sipas Ramës do të nisë akomodimi i tyre nëpër apartamente. Është domosdoshmëri përgatitja e fazës së akomodimit për ata që janë sot në hotele dhe për ata që janë në zonën rurale. Kam një merak shumë të madh për ata që janë në zonën rurale lidhur me nevojën për tu garantuar cilësi maksimale të tendave. Ministria e Mbrojtjes po punon çdo ditë së bashku me drejtuesin e plotfuqishëm, ministrin e turizmit dhe shtabin e emergencave në Durrës e Lezhë. Ka filluar përpilimi i listave për ata që nuk kthehen dot në shtëpi që janë në hotel. Duhet të fillojë identifikimi i të gjitha apartamenteve për t'u marrë me qira nga shteti. Nuk do t'i çojmë në kampe, nuk do t'i çojmë në çadra. Por do t'i çojmë në apartamente ku do të qëndrojnë me qira deri kur të bëhet rindërtimi. Rindërtimi do të zgjasë. Të gjithë ata të cilët nuk kthehen në shtëpi se e kanë të dëmtuar deri kur t'u riparohet shtëpia duhet të qëndrojnë si njerëz në apartamente. Nuk është e lehtë se janë shumë. Nga ana financiare do ta përballojmë ne, jo me çdo çmim qiraje se nuk do të lejojmë abuzivizma, por me çdo çmim nuk kuptimin e kostos së përgjithshme. Duke

filluar nga fillimi i janarit të fillojë kalimi i tyre në apartamente që të kenë minimumin jetik dinjitoz, jo në apartamente që të shkojnë të shtrihen në tokë, por me pajisjet minimale të domosdoshme, me mundësi që të ushqehen edhe me një kuotë të caktuar si edhe ndihma ushqimore.

GJENDJA E FATKEQËSISË NATYRORE

Tri gjendjet që diktojnë marrjen e mësive të jashtëzakonshme, përcaktohen nga Kushtetuta: "gjendja e luftës", "gjendja e jashtëzakonshme" dhe "gjendja e fatkeqësisë natyrore" (neni 170/1). "Gjendja e fatkeqësisë natyrore" nuk është kategori kushtetuese, por një shkallë administrative-ligjore e menaxhimit, në kuadër të mbrojtjes civile. "Gjendja e fatkeqësisë natyrore" mund të vendoset nga Këshilli i Ministrave për një periudhë 30-ditore dhe mund të zgjatet vetëm me pëlqimin e Kuvendit. Përpjessëtimi me situatën fatkeqe, ajo mund të jetë me karakter lokal, rajonal ose kombëtar, në varësi të shtrirjes së fatkeqësisë në territorin e Republikës. Kushtetuta përcakton organet përkatëse që propozojnë, miratojnë e shpallin gjendjet që kërkijnë masa të jashtëzakonshme, aktet që miratohen, si dhe kufizimet e të drejtave përgjatë ekzistencës së tyre. Ajo nënizon se në çdo rast, masat e jashtëzakonshme duhet të ndërmerrin sipas parimit të proporcionalitetit (në përpjessëtim me gjendjen që i ka diktuar ato), si dhe të parimit të aftësimit ripërtëritës, duke theksuar: "Aktet që ndërmerrin si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, duhet të janë në përpjessëtim me shkallën e rrëzit, duke duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve përfunksionimin normal të shtetit" (neni 170/4). Gjithashtu, Kushtetuta parashikon shprehimisht kufizimet e posaçme të të drejtave dhe lirive kushtetuese që mund të vijnë nga këto gjendje. Mënyra se si realizohen të drejtat dhe liritë themelore përgjatë "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", rregullohet më hollësisht nga ligji "Për mbrojtjen civile". Kështu, p.s.h., duke u fokusuar në të drejtën për informim, ky ligji, jo vetëm nuk e kufizon të drejtën për informim, por sanksionon në mënyrë të veçantë të drejtën e qytetarëve për të marrë informacion nga institucionet zyrtare. Madje, ai e parashikon informimin jo vetëm si një të drejtë, por edhe si një parim, krahas parimit për mbrojtjen e jetës, i cili, padyshim, zë vendin e parë. "Institucionet qendrore dhe vendore detyrohen të njofojnë komunitetin e një zone të caktuar, e cila ka rrezik të goditet nga fatkeqësitet natyrore apo fatkeqësitet e tjera" (neni 5 i ligjit).

Kështu, përmendim në mënyrë të veçantë, të drejtën për informim nga institucionet publike, të drejtat për mbrojtjen e jetës e të pronës së tyre, si dhe të drejtën për kompensim.

REFLEKTIM SOCIAL

Tërmëti ndodhi, shkaktoi katastrofën më madhe të gjysmëshekullit të fundit dhe Shqipëria mori atë që kishte bërë në këto 29 vjet: kaos, çoroditje, antishtet, papërgjegjshmëri dhe abuzim. 51 të vdekur dhe afro 1 mijë të plagosur eshtë një nga bilancet më të rënda të shkaktuar në një katastrofë natyrore në historinë e shtetit shqiptar. Por faji duhet kërkuar në tranzicionin tonë të gjatë, që tashmë po prek 3 dekada. Shteti u gjind i përgatitur. Kujtojmë se mëngjesin e 26 nëntorit, vetëm pak orë pas tërmëtit të fortë, nuk kishte organizim të shpejtë të institucioneve të emergencave civile. Heronjtë e atyre orëve të para postërmët ishin zjarrfikësit, Policia e Rendit dhe Policia Bashkiake, por këta nuk mjaftonin. Në një katastrofë natyrore, i pari që nis punën është specialisti i mirëfilltë për kësi rastesh, që shpëton jetë njerëzish në rrënoja dhe jo një polic i thjeshtë, që nuk e një fare këtë proces. Ky tërmët është një-kohësish edhe prova e madhe nëse ne do vijojmë t'i tolerojmë ata ndërtues dhe zyrtarë matrapazë që dhanë leje në kundërshtim me çdo standard. Është një provë për drejtësinë e reformuar që të hetojë, dhe të bëjë drejtësi. Solidariteti i këtij populli është jo thjesht i çuditshëm, por i paparashikueshëm. Një uragan solidariteti si asnjë komb tjetër në botë. Vargjet e atyre që kanë dhënë nga vetja për të ndihmuar të prekurit nga tërmëti janë vërtet mbresëlënëse. Kulmi i tyre është se këtij uragani i janë bashkuar aq natyrshëm edhe fëmijët që kanë dhënë edhe lodrat e tyre për bashkëmoshatarët që këto ditë janë në nevojë, dhjetra shqata, ambasada e subjekte ekonomike private. Stresi social bëri të veten. Burra e gra me fëmijë me vete lanë shtëpitë në Tiranë e Durrës dhe si karvanët e mesjetës iu turrën Jugut dhe Veriut të vendit pas katastrofës, duke lënë pas Shqipërinë e Mesme.

Tërmëti i 26 nëntorit tregoi se media shqiptare arrin majën profesionale kur trajton një fatkeqësi natyrore apo e thënë ndryshe, një ngjarje të paparashikuar. Një ngjarje që nuk e prodhon as politika, as qeveria e as opozita, por një ngjarje që e prodhon natyrë. Gazetarët e terrenit, kanë qenë vërtet heronjtë e këtyre ditëve. Heronj që kanë raportuar nga vendi i ngjarjes, atje kur kanë rezikuar dhe jetën, duke lënë me gisht në gojë analistët, që krekojnë në studio televizive. Tërmëti i 26 nëntorit tregoi se opozita edhe një herë tregoi vlerat e saj duke u bërë mbështetje, duke u integruar në terrenin konkret të fatkeqësisë natyrore dhe duke dhënë alternativë e saj. Ajo heshtë këtë herë përballë kësaj fatkeqësie të përbashkët edhe pse kjo qëveri kërkojë ngahera të dorëhiqet si e paaftë dhe e korruptuar.

KOSOVA, SHEMBULL I LARTË SOLIDARITETI. KOSOVARET U TREGUAN TË GATSHËM SI VLLAI PËR VELLAIN

Kosova me ndërrën shekullore të bashkimit kombëtarë është shpirtërisht më e bashkuar se kurrë. Jemi dy shtete, por një komb, kemi një identitet kombëtar, që është identiteti shqiptar. Kjo tregon më së miri se bashkimi shpirtëror shqiptar kombëtarë është i arrirë. Solidariteti u shtrit edhe përtëj Adriatikut e Jonit. Solidariteti i shteteve të tjera me Shqipërinë e dëmtuar nga tërmëti është besues, pasi, prisnim amerikanët, por jo serbët dhe grekët. I prisnim italianët, por jo francezët. Ky ishte kulmi i solidaritetit të kombeve dhe shteteve të tjera, që simbolikisht treguan se nuk jemi vetë dhe të izoluar por me plot miq dhe partner të besueshëm në rrugën e demokracisë që kemi nisur të ndërtojmë.

tragjedia

TRAGJEDI E PAPARË NË FAMILJEN LALA

E martë 26 nëntor. Ngjitur me vilën katër katëshe të familjes së madhe Lala jetonte edhe ajo e Feim Imerajt, që tregoi se ishte për ta një fqinj i mirë në gjëzime e hidhërimë. Feimi jetonte përballë tyre me gruan Bukurien dhe fëmijët, aty në zonën e Kënetës në Durrës. Bukuria tregon me nostalji kohën kur ishin njojur me Lala, rreth dy dekada më parë. "Njihemi që prej 18 vitesh kur hidhni themelat e shtëpisë në të njëjtën kohë..por ata e mbaruan me vonesë ndërtimin..vetëm dy vite kishin që kishin ardhur nga Peshkopja ishin tre kurore bashkë." 26 nëntori qe fatale për këtë familje. Ora shënon te rrëth 2 e 50 minuta të mëngjesit kur dridhja e parë e tokës i zgjoi ata nga gjumi... të alarmuar Feimi dhe Bukuria rrëmbyen të përgjumur fëmijët dhe dolën jashtë shtëpisë për të shpëtar, u kujtuan edhe për Marjetën të cilën e thirrën nga jashtë për ta ndihmuar. "E dëgjuam tërmetin e parë dhe dolëm..doli edhe Marjeta..i thirrëm edhe asaj doli edhe ajo..më pas u kthyem të gjithë në banesa" thotë Bukurie Lala. Me katër fëmijët e saj Marjeta u rikthye në banesë, nuk u ngjit më në katin e katërt por mbësh-tollë fëmijët me krahpë dhe qëndroi dy më poshtë bashkë me vjehrën, kunitin e paralizuar dhe dy fëmijët e kunitit tjetër, për tu ndjerë më e sigurt. Nuk vonoi shumë dhe toka u drodh sërisht në orën 3:55 minuta. Në ato sekonda fatale Feimi zbriti nxitimthi për t'ndihmuar edhe njëherë, por nga brenda përgjigjet ishin të pakta. "Kur u bë dridhja e dytë unë u mora me fëmijët e mi ndërsa burri shkoi tek ata për t'ndihmuar. I thamë të të ndihmojmë për kalamajtë t'zbresim. Ajo tha po i marr fëmijët po i bashkoj bashkë. I kishte nëpër gjumë." Pasi toka pushoi së zhurmuary e lëkunduri dhe mori atë që deshi, aty nuk pipën-tinte më asgjë. "Por nuk kishe ç'të shihje, mjegull e krisje, cdo gjë u bë rrafsh, dy katet humbën fare, porta ishte e mbyllur dhe nuk dëgjohej më asgjë.." Feimi ka thirrur sërisht dhe prej andej ka dëgjuar vetëm 17 vjeçarin Ramë Lala të cilit arri-ti t'i dërgonte ujë përmes një tubi, e më pas lajmëroi policinë. E vetëm teksha dita po zbardhete u pa se vila katër katëshe e familjes Lala, brenda së cilës banonin tre kurore, dukej si një pemë me degët e thyera pas një stuhie nuk mbajti më duke u shkulur me rrënje.. "Pas gjashtë orësh u shemb komplet banesa, por atëherë kishte mbaruar cdo gjë" Djaloshi 17 vjeçar Ramë Lala qëndroi aty poshtë rrënojave për orë të tëra duke luftuar me jetën dhe fatmirësish ia doli, zjarrfikësit arritën ta nxirrin prej andej të gjallë. Por ai nuk e dinte që poshtë të afërmisht e tij ishin shuar përgjithmonë. Bukuria dhe bashkëshorti i saj efektivi i policisë Feim Imeraj nuk i braktisën fqinjtë edhe të vdekur. Ata hapën dyert e mortit për t'i përcelljur me dinjitet 8 anëtarët e familjes Lala në banesën e tyre të fundit. Ndërsa shtëpia e Imerajve u rezistoi lëkundjeve të tokës, e kundërtë ndodhi me vilën katër katëshe përballë tyre. Fqinjt Lala i kishin treguar Bukuries se shtëpia



kishte pasur problem me shkallët që në tërmetin e parë, atë të 21 shtatorit, por kjo ishte vlerësuar si jo problematice nga inspektorët e bashkisë. "Problem me shkallët kishte që në tërmetin e 21 shtatorit, shkallët u krisën që atëherë.. erdhën e panë por u thanë që kaq krisje nuk ka problem." Sahadete Lala, i biri Iliri dhe mbesa e saj Griselda, Marjeta Lala dhe fëmijët e saj Amelia, Emilio, binjakët dy vjeçarë Dionis e Dionisa u rikthyen në atë shtëpi të ndërtuar me sakrifica pa e ditur se aty do të jetonin vetëm dy muaj të tjerë deri më 26 nëntor.

NIPI RRËFEN MOMENTET E TMERRIT

Ende nuk kishte zbardhur e marta e 26 nëntorit, kur Indrit Markja, nipi i familjes Lala, të cilës tërmeti shkatërrimtar iu mori jetën 8 pjesëtarëve të saj, u zgjua nga një telefonatë. Një zë nga Shqipëria, i tha se shtëpia trekatëshe e dajave të tij në ish Kënetë ishte shkatërruar nga lëkundjet dhe nëntë të afërmisht e tij kishin mbetur në rrënoja. "Na, erdhni një telefonatë dhe na tha se shtëpia e nënës është shembur. Kam dëgjuar mamin duke qarë. Jam ngritur dhe direkt jam nisur për në Aeroportin e Romës, për të ardhur për këtë", -tha Indriti. Mes lotësh, Indriti, i rritur në Itali, rrëfen tmerrin që përfjetoi kur u gjend pranë banesës së shkatërruar. "Është e paimagjinueshme, nuk ka shpëgim, duke e ditur çfarë kishte aty brenda, ishin kalamajtë e dajës, daja, nëna, dhe goça e dajës.", -pohoi ai.

Shtatë ditë më vonë nga e marta e kobshme, nipi i familjes thotë se ata kanë humbur shumë, por fakti që tragjedisë i mbijetoi Rama, djali i njërit prej dajave, është një dritë shprese për ta. Ai na rrëfen takimin me 17-vjeçarin në spitalin e Traumës dhe arsyet përsë e shmangete bisedën më te, për çfarë kishte përfjetuar adoleshenti nën rrënoja. "Ai është i terrorizuar, sepse edhe kur vajta unë në Tiranë kur e takova po binte akoma tërmet. Ai thoshte 'tërmet, largohuni, largohuni'. I thova që 'po e lëviz unë krevarin', ai më thoshte 'mos e prek as ti atë krevat'. Është shumë i terrorizuar, ndaj e çuan në Itali.", tha Indriti. Por a shpresoi Indriti se veç Romës, mund t'ja dilnin dhe të tjerët të mbijetonin? "Shpresën e kam pas gjithmonë. Në momentin që humba avionin, po shikoja live lajmet, duke pritur. Edhe pse zemra më thoshte se është e vështirë, por shpresa kam patur. Edhe kur erdhë këtu bashkëpunova me zjarrfikëset italiane, duke ditur projektimin e shtëpisë", rrëfen Indriti. Pas tragedisë, pjesëtarët e familjes ardhur

nga Peshkopja janë strehuar në banesat sociale në Shkodër, por nipi i tyre thotë se po mendojnë t'i tërheqin ata drejt Italisë, të paktën Albertin, djën që humbi të gjithë familjen. "Që ditën e parë që kam ardhur i kam qëndruar afër dajës. Se me të jam rritur, ai ka qenë në Itali, rrinte me ma. Jam shumë i lidhur me të. Që do të ndërtojë shtëpi tjetër këtu, nuk e besoj, është e pamundur. Sigurisht që do ta marr, nuk do ta lëmë vetëm, sepse ai ka nevojë për ne", theksoi nipi i familjes Lala. Nga vila trekështë e familjes Lala, nuk ka mbetur më asgjë. Në rrënoja gjen këpucët dhe djepin e Dionisit, kukullat e motrës binjake, Dionisës, librat e Emiliос dhe Amelas, rrobat e Marjetës. Nëna bashkë me 4 fëmijët nuk mbijetoit dot, sikurse fatkeqësisht nuk ja dolën as nëna efamiljes Sahadetja, i biri iliri dhe mbesa Grisilda.

HUMBËN 9 PERSONA NGA FAMILJA LALA. ZHVENDOSEN NË BANESA TË REJA NË TIRANË.

Pak ditë pas tërmetit katastrofik, që i mori tetë anëtarë, familja Lala nga Kënetë e Durrësit, është bërë me banesë të re. Kryeministri Edi Rama ka vënë në dispozicion apartamentet te banesat sociale në Shkodër, Tiranë, për këtë familje dhe persona të tjerë që humbën familjarët nga tërmeti në Thumanë e Durrës. Mbrëmjen e kaluar tragedia u rëndua akoma më shumë në këtë familje, pasi ndërrroi edhe Fiqirete Lala 64 vjeçë, pas ceremonisë mortore, pasi nuk e përballoi dot dhimbjen e madhe. "Kjo është shtëpia juaj tani. Keni tre shtëpi në këtë apartament", u tha Rama familjarëve. Ndërsa Veliaj theksoi se do të kenë edhe një mjeq në dispozicion, por edhe ushqim me vaktet falas. "Ata nuk i kthejmë dot" tha Rama, ndërsa u tha familjarëve se "Për çfarë t'keni nevojë unë jam këtu. Unë e dija që ju nuk do të rrinit atje, prandaj atje do të ndërtojmë një çerdhe". Kryeministri u kërkoi banorëve që t'i presin me ngrohtësi anëtarët dhe t'i trajtojnë me kujdes. Vëllezërit dhe motrat e familjes janë zhvendosur në Tiranë tashmë te banesat sociale. Anëtarët e familjes Lala që u shuan nga tërmeti tragik:

1. Amelia Lala 8 vjeç – Vila në Kënetë
2. Sahadete Lala 79 vjeç – Vila tek Kënetë (Gjyshja dhe mbesa)
3. Griselda Lala- 22-vjeç – Vila tek Kënetë
4. Marjeta Lala 31 vjeç
5. Emilio Lala
6. Enis Lala 2 vjeç -binjakë në Vilën në Kënetë
7. Dionisa Lala 2 vjeç -binjakë në Vilën në Kënetë

Fqinjtë e familjes Lala me origjinalë nga Dibra rrëfenjë tmerrin e tërmetit

8. Ilir Lala, 52 vjeç, i fundit qe u nxorr nga vila, në Kënetë

9. Fiqirete Lala, 64 vjeçë, ndërroi jetë gjatë drekës së varrimit të 8 familjarëve

META NË HOMAZHET PËR FAMILJEN LALA: E PAMUNDUR TË GJESH FJALË NGUSHËLLIMI



Presidenti i Republikës Ilir Meta ka marrë pjesë në homazhet për anëtarët e familjes Lala që humbën jetën si pasojë e tërmetit katastrofik që goditi vendin më 26 nëntor, në Durrës. "E pamundur të gjesh fjalë për të ngushëlluar familjen Lala pas kësaj tragedie të tmerrshme. Zoti u dhëntë forcë për ta përballuar këtë dhimbje të pangushëllueshme. Është detyrimi ynë për t'i qëndruar pranë atyre gjithmonë", është shprehur Meta.

17-VJECARI RAMË LALA U NISET DREJT ITALISË PËR KURIM, VAZHDOJNË KËRKIMET PËR XHAXHANE



Nuk përballoi dot dhimbjen, ndërron jetë në drekën e varrimit anëtarja e 9-të e familjes Lala

Rëndohet bilanci i tragedisë në familjen Lala, në zonën e Kënetës, në Durrës, që ishte dhe një ndër familjet më të prekura të tërmetit katastrofik të 26 nëntorit, duke e cuar në 9 numrin e të vdekurve. Gazetarja Klodianë Lala raporton për "Balkanëeb" se ka ndërruar jetë një tjetër anëtarë e kësaj familjeje, e cila humbi tragjikisht tetë anëtarë të saj nën rrënojat e tërmetit. Bëhet fjalë për shtetasen Fiqirete Lala, që është nusja e djalit të madh të familjes Lala. Ajo ka ndërruar jetë në drekën e varrimit të 8 anëtarëve të familjes së saj, pasi nuk e ka përballuar dot dhimbjen e madhe.

"BINJAKËT U GJETËN NË KRAHËT E NËNËS", DURRËSI NË ZI PËR TRAGJEDINË NË FAMILJEN LALA

Familja Lala, e cila jetonte në banesën e tyre në zonën e ish-Kënetës në Durrës ka humbur 8 anëtarë të familjes, duke qenë familja më e prekur nga tërmeti tragik i natës së 26 nëntorit. Me dhimbjen e kësaj familje janë bashkuar familjarë e miq, por edhe qytetarë të Durrësit, pasi gjithë qyteti është goditur e është në zi. Mes tjerash, edhe personalitetë të politikës shqiptare, i kanë dhënë lamtumirën dy binjakëve, por edhe Amelias e Emilio. Po iu jetep lamtumira gjyshe dhe nënës së kësaj familje. Ata janë gjetur nën rrënoja duke mbrojtur fëmijët, por nuk kanë dale gjallë prej andej. Po i jetep lamtumirë edhe Griseldës, një studente e Universitetit të Durrësit. Po i jetep lamtumira e fundit edhe Ilirit, xhaxhia të fëmijëve



Po na ikin nga Shqipëria njerëz me vlerë si Agron Tufa, dhe na kanë mbetur horrat e zuzarët



AGRON GJEKMARKAJ

"Njëri prej shkrimtarëve më në zë të vendit tonë u detyrua të ikë nga Shqipëria për të mbrojtur veten dhe familjen.

Pos kësaj ai ishte edhe një zyrtar i lartë publik në krye të Institutit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, ku ka bërë një punë të admirueshme në rikthimin e të vërtetave historike mes nesh, e sido-

mos në zbardhjen e këtyre krimeve dhe vendosjen e gishtit te kriminelët.

Ne kemi patur dhe kemi një histori ideologjike të manipuluar. Tufa tentoi ta ndryshonte këtë tendencë, por u ndesh me dhunë verbale të ekspONENTËVE qeveritarë, me sharje e fyerje nga bij gjakatash, kërcënime rruge dhe me sa duket iu bë e pamundur jeta në këtë vend.


E rëndë, tejet e rëndë për një vend që detyron shkrimtarët e vet më spikatur, të ikin nëpër natë për të mos u shndërruar në viktimë e ideve dhe punës së tyre.

Kjo shoqëri duhet të pyesë veten në çfarë sistemi jetojmë? Pse po i negocojmë çdo ditë liritë dhe të drejtatn tona? Pse po i dëbojmë intelektualët dhe shkrimtarët dhe në vend të tyre adhurojmë horrat e zuzarët?

Diçka e madhe është kalbur në këtë vend.

E kaluara sundon mbi të tashmen dhe kërcënont të ardhmen me tmerret e veta! Agron Tufa i duhet kulturës shqiptare i gjallë, jo i vdekur.

Pas ikjes së Kadaresë, e cila i ndikoi shqiptarët 30 vjet më parë, do të dëshiroja shumë që edhe ikja



e Tufës të bëjë të njëtin efekt në kontekstin e ritë rrethanave tona. Ikja, arratisja, kërkesa për azil, e mbi të gjitha kërcënimet ndaj një shkrimtar si Agron Tufa, kaq cilësor e me ndikim, janë një lajm i keq, tejet i keq, përzhitës", shkruan Gjekmarkaj.

Krimi dhe mungesa e shtetit të së drejtës detyrojnë shqiptarët të largohen

Fatkeqësia më e madhe që i shaktoi Shqipërisë qeveria e të ashutuquajturës "Rilindje" janë krimi qeveritar, mafia e lidhur me qeverinë, korruptioni galopant. Pikërisht për të shpëtuar prej kësaj tragedie kombëtare më shumë se 500 mijë shqiptarë kanë braktisur vendlindjen e tyre këto gjashtë vitet e fundit të qeverisës së pseudomazhorancës së majtë. Sipas INSTAT-it, nga viti 2011 deri më 2017, janë larguar nga Shqipëria 330 mijë shqiptarë si emigrantë. Po aq është shifra e të larguarve edhe këto dy vitet e fundit. Dhe nuk është vetëm kriza ekonomike pa rrugëdalje që detyron shqiptarët të largohen, por, përsekutimi e përndjekja politike si në kohën e diktaturës. Shembujt janë të shumtë... Policia sillet me qytetarët në mënyrë arbitrale, duke i dhunuar në shkelje të hapur të ligjit.

Rasti më konkret është ai i qytetarit Nexhmedin Syla që u torturua barbarisht nga mercenaret e kësaj qeverie, vetëm pse doli më hapur se të gjithë në fushatën e ndërgjegjësimit për luftën pa kompromis kundër krimit në Tirane dhe Kukës. Ai u përball me kufinjtë e vdekjes. Ja pra, kjo është arsyaja pse ikin shqiptarët nga mjerimi dhe mungesa e ligjit dhe drejtësisë, nga dhuna dhe torturat, nga persekuimit politike. Ja pra pse e braktisën Shqipërine Dritan Zagani, Nexhmedin Syla dhe së fundi edhe Publicisti, shkrimtari e poeti Agron Tufa, i cili drejtonte Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, i cili bashkë me familjen e tij, ka kërkuar azil politik jashtë vendit. Tufa u largua nga Shqipëria pas kishte marrë disa kërcënime me jetë për shkak të pozicionit të tij si drejtori i Institutit.

Tridhjete vite progress politik dhe demokratik apo rigres politik dhe demokratik? Koha po e provon qe e dyta eshte me mbizoteresue ne aktullitetin shqiptar.

Shqiptarët, në historinë e shtetit të tyre nuk mbajnë mend qeveri më të korruptuar dhe më kriminale se sa kjo e kryeministrat Edi Rama e këtyre gjashtë viteve të fundit.



Ai ka kthyer në drejtimin e institucioneve pinjollët e ish udhëheqësve komuniste të sistemit të diktaturës. Në ministrinë e Brendëshme, atë të drejtësisë si edhe në të famshmit inspektoriate punohet me metodat e shtetit të djeshëm monist. Dhe fatkësia me e madhe është identifikimi dhe përndjekja e hapur prej tyre e kundërshtarëve politike, burgosja e keqtrajtimit i tyre në mënyra nga më brutalet.

Kështu ka ndodhur me Mexhbedin Sylën....Me po të nejtitat metoda u kërcënua edhe Agron Tufa. Ai shkruan se ka kërkuar azil politik, pasi ka marrë kërcënime të vazhdueshme për jetën. Madje, ai shkuan se në dy herë brenda muajit nëntor, këta persona për të cilin shprehët se e di se kush janë dhe çfarë janë të aftë të bëjnë, i kanë kërcënuar dhe familjen e tij.

Në shtator të 2019, një person i panjohur kërcënoi shkrimtarin dhe avokatin e tij Kujtim Cakrani përmes një mesazhi në Facebook:

"Ju ballista e fashista, që sot bëheni avoketër dhe kërkoni të mbroni sojin tuaj, që nxin luftën e hedh baltë dëshmorëve, jeni ata të djeshmit, që duheshit vrarë, të mos mbinit ju e

Rasti më konkret është ai i qytetarit Nexhmedin Syla që u torturua barbarisht nga mercenaret e kësaj qeverie, vetëm pse doli më hapur se të gjithë në fushatën e ndërgjegjësimit për luftën pa kompromis kundër krimit në Tirane dhe Kukës. Ai u përball me kufinjtë e vdekjes

që keni marrë zemër sot. S'ka avokat në botë të fshijë gjakun e tyre dhe të mbrojë atë Institut kriminel me Agron Tufë e të tjerë se ju jeni më të poshtë se armiqtë që mbroni...

Ju dhe familjarët tuaj ballistë e fashistë nuk do keni vend më tek ne, se e shkruat vetë fundin tuaj. Si dolët

avash nga llumi, si pa kuptuar, ashtu do t'ju heqim dhe ne avash të mëdhenj e të vegjël, se ka qenë gabim i madh që për ju pati mëshirë. Të gjithëve gropa ju pret!". Kreth 6 muaj më parë, deputetë socialistë e cilësuani punën e Institut "baltë mbi dëshmorët" dhe kërkuan largimin e drejtorit Agron Tufa. Ndërsa në muajin korrik, socialistët kufizuan me ligj periudhën kohore të studimeve që mund të kryejë ISKPK.

Agron Tufa, gjatë kësaj kohe, ka patur përplasje, edhe me deputetë socialistë, ndërsa ka mbështetur padinë ndaj ish-komandantit të burgut të Qafë-Barit, Edmond Caja, i akuzuar për dhunë sistematike ndaj ish-të burgosurve. Është fatkeqësi e madhe për Shqipërinë, kur qytetarët e saj e kon siderojnë atdheun një vend të përkohshëm! Vargu i atyre që ikin nga ky vend nuk mbaron dhe popullsia e atdheut tonë tkurret e tkurret, përmes një dukurie që gjithashtu nuk paska fund.

Shkëlzen Dhoksi

TREGU I SHUPENZËS PA ASNJË KUSHT, PRET INVESTIM NGA BASHKIA BULQIZË. FERMERËT ANKOHEN EDHE PËR MUNGESË TË SHITJES

Trgu i Shupenzës tashme ka krijuar traditen tregtarë dhe qytetarinë. Çdo javë ai mbushet plot me prodhime bujqësore dhe blektorale që vijnë nga fshatrat e zonave përreth. Produktet që tregëtohen janë të një cilesie të lartë ashtu siç janë në përgjithësi prodhimet e Dibrës. Por ende kësaj tradite nuk po i vjen në nduihmë shteti. Duhet të krijohet sa më parë infrastruktura e një tregu modern ku të ketë standartet e tregjeve të qyteteve të tjera. Dhjetra fermerë të fshatrave të Dibrës e Bulqizës mblidhen çdo të dielë në Shupenzë për të treguar prodhimet e tyre. Por ndonëse ky është një ndërt tregjet tradicionale të zonës i cili është përdorur prej dekadash, askush nuk ka menduar për përmirësimin e kushteve të tij, duke i lënë fermerët në qill të hapur. Megjithëse nuk kanë kushte, vetë tregtarët thonë se paguajnë taksën sa



herë që dalin aty. Por si të mos mjaf-tonin kushtet skandalozë ku ata tregtojnë prodhimet e mbledhura gjatë këtij viti, fermerët thonë se po përballen edhe me mungesë të fuqisë blerëse e kjo ka bërë që çmimet të janë shumë të ulta. Tregtarët thonë se çmimi i shumë produkteve ka rënë ndjeshëm, duke mos mbuluar as koston deri në prodhim. Shupenza pret investim pëtregun e ri.

Publicisti, poeti dhe studiuesi Sakip Cami, promovon librin e 20-të

promovimi

“LANÇ në Dibër”, vepër dinjitoze në fondin e letërsisë sonë dokumentare



Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar (OBVL) dhe Shtëpia Botuese "M&B", në vigilje të jubileut të lavigjimit të 75-vjetorit të cilirimit të atdheut, promovuan librin "LANÇ në Dibër", që u vlerësua si një ndër veprat më të arrira të publicistikët, poetit e shkrimtarit, tashmë të mirënjohur Sakip Cami. Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, Kryetari i OBVL kol.ing. Myfit Guxholli, prof. dr. Bernard Zotaj, prof. dr. Zaho Golemi, nën kryetari i OVLANÇ të Kosovës Bashkim Hisari, kreun i Unionit të Krijuesve dibrani Fatos Daci, historiani Mehmet Hasani, ish-ministrja e Arsimit Tefta Cami si dhe botuesi Bujar Karoshi evidentuan vlerat e këtij libri që mbush vaakumin e krijuar për një nga periudhat më të lavdishme të historisë së Shqipërisë. Ky libër që u promovua më 24 Nëntor 2019 në sallën "Shpataraku" të Muzeut Kombëtar në prani të elitës intelektuale dibrane dhe personaliteteve tjera akademike të kryeqytetit, i botuar në kuadrin e 75-vjetorit të cilirimit të atdheut nga okupatori nazifashist, hyn me dinjitet në fondin e artë të letërsisë dokumentare. Redaktori i librit "LANÇ në Dibër", z. Halil Rama, që ishte dhe moderator i këtij aktiviteti promovues, ndër të tjera tha se "LANÇ në Dibër" është libri që hedh dritë për ngjarje e fakte të mbeturë disi në errësirë, ose të shtrembejëruara qëllimisht e të pasqyruara si të tilla nga historiografia e viteve të para '90-tës.

Sipas tij, "LANÇ në Dibër" është një veprë dinjitoze e autorit S.Cami që pasuron dukshëm fondin e letërsisë sonë dokumentare. Kjo edhe përfaktin se autori pasqyron me përgjegjësi ngjarje e fakte historike nga aktiviteti i çetave luftarakë (Të Dibrës e të Gollobor-dës, të Batalionit partizan të Dibrës e Brigadës XVII S, si dhe pasqyron veprimitarinë e misionit anglez në Dibër të shoqëruar pothuajse gjatë gjithë kohës nga Dan Kaloshi. Po ashtu autori sjell referenca mjaftë të besueshme nga: Prof.Bernd Fischer, Reginald Hibbert, Fondi i Gjeneral Alberto Parianit (mars-korrik 1943), Neubacher (I dërguar special i Hitlerit për Ballkanin) e nga dhjetra botime të autorëve shqiptarë, duke u ndalur veçmas tek Lufta kundër fashistëve italianë në Dibër

e Dibër të Madhe; Lufta kundër nazistëve gjermanë në Dibër si dhe tek Lufta e njësive të mëdha partizane. Kryeredakto i gazetës "Veterani" H.Rama, njëherësh redaktor i këtij libri vlerësoi gjithashtu mënyrën dhe stilin e veçantë të të shkruarit nga autor. S.Cami. Duke përshëndetur pjesëmarrësit e shumtë në këtë aktivitet promovues, zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi vlerësoi Luftën Antifashiste Nacionalçirimitare si një një zgjedhje politike dhe ushtarakë të mençur dhe dinjitoze të popullit shqiptar.

Pasi përgëzoi autorin Sakip Cami për këtë veprë dinjitoze, numri dy i dikasterit të Mbrojtjes tha se LANÇ ishte një përcaktim politik dhe ushtarak i Shqipërisë në krahun e duhur gjatë Luftës së II-të Botërore. "Jemi krenarë për mençurinë, sakrificën dhe përkushtimin ushtarak të partizaneve që bënë LANÇ dhe të popullit tonë antifashist", tha z.Koçi. Më tej, duke reaguar kundër spekulantëve dhe shtremëruesve të historisë së LANÇ, ai tha se "shqiptaret janë dhe do të mbeten antifashistë! Nuk u turpëruan dot gjatë Luftës së II-të Botërore dhe nuk i turpëron dot askush". Zëvendësministri i Mbrojtjes vlerësoi heronjtë dhe dëshmorët e LANÇ si simbolin më kuqimplotë të nacionalizmit me vepra dhe jo me fjalë. Dhe padyshim, ai që ngjalli interes të jashëzakonshëm në këtë aktivitet promovues të librit të autorit Cami "LANÇ në Dibër", ishte kreu i OBVL, kol.ing.Myfit Guxholli. Si pjesëmarrës aktiv në LANÇ, ai rrëfeu për pjesëmarrësit kohën kur i inkuadruar në Brigadën e IV-t Sulmuese mori pjesë në luftimet në Zerqan, Dibër të Madhe e Peshkopi, kundër pushtuesve gjermanë dhe mercenarëve vendas të lidhur me pushtuesin.

Prof.dr.Bernard Zotaj, duke evidentuar vlerat dhe veçoritë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër, ndër të tjera tha se " Përmes këtij libri autor i sjell ndihmesën e tij në trajtimin e plotë dhe mbi baza dokumentare të njërsës prej zonave më të veçanta e më të mëdha si Dibra, për kohën kur veproi, duke sjellë njëherësh dhe një ndihmesë të çmuar në fushën e

Historisë Ushtarake Shqiptare. Autori është përpjekur dhe i'a ka arritur të rindërtojë të plotë imazhin e kësaj zone luftarake, me veçoritë e veta dalluese si në organizim ashtu edhe në veprimtarinë e dendur luftarake, pa lënë jashtë trajtese edhe rolin e spikatur të saj, si një burim njerëzor për ngritjen e çetave, batalioneve dhe të brigadës sulmuese. Në punim, për herë të parë jepet e tërë skema e veçantë organizative, e plotësuar tashmë dhe me të dhënat për drejtuesit kryesor, si dhe me dukuritë e risitë e veprimtarisë luftarake të njësive që vepruan në Dibër. Madje aty sillen në mënyrë të plotë mjaft të dhëna e statistika përmbi formacionet ekzistuese para krijimit dhe të tjerave që u formuan më pas, gjatë veprimtarisë së luftës". Më tej, Prof.dr.Zaho Golemi – ish-Drejtor i Arkivit të Ministrisë së Mbrojtjes, pasi përgëzoi autorin për këtë vepër dinjitoze, tha se Dibra radhitet ndër rrethet me numrin më të madh të dëshmorëve. Rreth profitit krijues të autorit Sakip Cami, autor i 20 librave me poezi, prozë, monografie studime, foli kryetari i Unionit të krijuesve dibranë, z.Fatos Daci që është njëherësh edhe anëtar i Akademisë shqiptaro-amerikane të Shkencave. Ndërsa studjuesi Mehmet Hasani foli për veçoritë e LANÇ në zonën e Gollobordës, të pasqyruara gjëresisht në këtë vepër të autorit S.Cami. Vlerat krijuese të këtij autori i evidentoi më dukshëm administratori i Shtëpisë Botuese "M&B" Bujar Karoshi, i cili veçoi seriozitetin e z.Cami në mbledhjen dhe trajtimin e faktave, cilësinë dhe produktivitetin në krijimtarinë e tij letrare e publicistike. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet promovues i përshëndeti edhe nënkyetari i OVLANÇ të Kosovës, publicisti i mirënjohur Bashkim Hisari. Pasi uroi autorin Cami për këtë kontribut të çmuar në historiografinë e re shqiptare, ai tha se promovime të tillë janë një shembull frymëzimi edhe për drejtuesit e OVLANÇ të Kosovës. Rreth vlerave të librit dhe për ngjarje konkrete të LANÇ në Dibër foli edhe ish-ministrja e Arsimit dhe Kulturës Tefta Cami. Në këtë atmosferë festive, për pjesëmarrësit u shtrua dhe një koktejl.



Me mjeshtri të rrallë artistike, me një guhë të pasur e mjete shprehëse interesante autori ekzaminon atë Parti që “kishte për detyrë të ndërhynte edhe në trillet e fshehta dashurore të anëtarëve të saj”

Kumtim për romanin “Dëmtuar gjatë rrugës” të Besnik Mustafajt, shpallur “Autori më i mirë i vitit” në Panairin e Librit 2019

Një palë opinga për Hrushovin?!

HALIL RAMA

Ditën e fundit të Panairit të Librit 2019, të dielën e 17 Nëntorit, m'u desh të shkoja tri herë në Pallatin e Kongreseve. Dy herët e parades, mungonte, pasi ishte shitur tri ditët e para, ndërsa në mesditë erdhë i ribotuar romanit fitues i këtij panairi “Dëmtuar gjatë rrugës”. U ndjeva me fat që e mora me autografin e autorit Besnik Mustafaj. Por më me fat u ndjeva pasi e lexova këtë roman, vërtetë me fund të lumtur.

Personazhi, me fund të lumtur është Nëna e autorit. Një fund i lumtur pas një makthi që e kishte pushtuar atë prej tri dekadash se mos një ditë do t'i hapeshin petët e lakrorit....

Ajo kishte shkelur për herë të parë kur ishte 24-vjeçë në një zyrë të vërtetë të pushtetit “atje ku ndihet si frikë deri në kockë hija e rëndë e shtetit”. Siç pohon autori që në krye të herës “është një histori, të cilën ajo e ka mbajtur brenda kokës së vet si një tumor (fjalët e saj) për tridhjetë vjet”.

Dhe ky “tumor” s'ishte gjë tjeter veçse brengë që i çelën një palë opinga, që ajo u detyrua atë pranverë të largët të vitit 1959 nga më i madhi i partisë së krahinës, t'i qëndiste si dhuratë për Nikita Hrushovin, në vizitën e tij të parë në Shqipëri. Që nga marrja e porosisë prej ish-Sekretarit të parë të PPSH të rrerith përtë krijuar një palë opinga artistike, që do të përbënën “sekret shtetëror”, personazhi kryesor i romanit “do të mendonte me bindje të rrënjosur një herë e përgjithmonë se sidomos zyrat e politikanëve të lartë janë të mbushura me mistere djallëzore, ku njeriu i pamësuar zbulon pafuqinë e vet, duke pësuar në shpirt gjymtime të papërfytyrshme”.

Në thelb, subjekti ka dy pamje: Pamjen gazmore kur pasi iu pëlqyen “opingat” artistike që kasta e atëherëshme ia dhuroi Hrushovit, të cilësuar si “babai i popujve”, nëna u bë “Shoqja S” dhe përzgjidhej si politikane re “yll në ngjitet” në tribunat e mitingjeve ku brohoritej “Rroftë Hrushovi”, dhe pamjen e zyrtë gjatë gjithë viteve të mëpastajme, kur ajo dyshonte se mos shpalaje armike, pikërisht pse kishte krijuar “opingat artistike” për Hrushovin që ishte shpallur armik i revolucionit bolshevik nga mbrojtësi i flaktë dhe i vetëm i tij, Enver Hoxha.

PËRSHKRIM BRILANT I LËMSHIT TORTURUES TË LOTËVE TË NJË NËNE

Autori, si rrallëkush tjetër ka ndërtuar profilin e nënës së tij, nëpërmjet dialogesh me të vjerrin dhe monologeve me vetveten, gjatë procesit të thurjes së opingave “sekret shtetëror” dhe në vijim përfrikë se mos pas “tradhtisë” së Hrushovit edhe ajo mund të shpalaje armike dhe ta pësonin i biri, vëlezërit dhe gjithë farefisi i saj.

Të krijosh një roman kaq të arrirë artistikisht vetëm mbi këtë subjekt është vërtetë një meritë e vecantë e këtij autori, që si askush tjetër përshkuar lëmshin torturues të lotëve që ia kishin zënë lëfytin e hollë të grykës, kësaj nëne fisonike që s'mendonte për asgjë tjetër (nëse do ta arrestonin) veçse për të ardhmen e djalit foshnjarak (në djep). Dhe kur u bind se nuk kishte më asnjë rrugë shpëtimi “një zë, që ishte zëri i saj, edhe pse nuk dilte nga goja e saj, zuri të këndonte vajtueshmë: “Një amanet po jua la:/Kur në mur-o t'më murosni,/Syn’ e djathtë t’ma leni jashtë,/Kambn’ e djathtë t’ma leni jashtë,/Gjin’ e djathtë t’ma leni jashtë:/Se kam lanë djalin e vogël/E kur t’nsi djali gjamën,/Me njan’ sy ta shikoj,/Me njan’ dorë ta limoj,/Me njan’kambë ta lurtoj,/Me njan’ gji ta nergoj.”. Amaneti i një nane që “opinga artistike” mendonte se duheshin thurur veç përburri e saj dhe për asnjë burrë tjetër në botë.

“Mrekullia, që duhej të nxirrte Nëna ime nga duart e veta ‘vetëm me një grep e pe të bardhë’ishin një palë opinga burrash”. Por për të “Fqinjëria e fjalëve SEKRET dhe SHTETËROR krijonte një bashkim tingullor tepër të frikshëm”. Madje sipas saj “vetëm zyrat mund të bënin sajime të tillë gjuhësore, që t'i përshkonin veshët dhe trurin si turjela”. Piërisht mbi rrëfime të tillë brilante autori ndëronton intrigën për “pyetjet e përsëritura edhe pse të mbetur pa përgjigje si dhe dyshimet e njëpasnjeshme dhe gjithnjë të pasqaruara” që ngadalësojnë tej mase rrëdhën e kohës. Dhe gjithshka “për shkak të atij të mallkuarit, sekretit shtetëror!”. Ishte ajo kohë e misterë dhe e kobshme kur mund ta haje po të nxirri se sekretin e thurjes së një palë opinga artistike, pasi përbënte “rrezik të madh të génjehet Partia”.

Pikërisht në këtë kontekst e paraqet auroi edhe mërdhënien e nënës së tij me Dritën, kushëriren e burrit të saj që veteveti “do ta fusnin shoqja shoqen në sku-



DËMTUAR GJATË RRUGËS

roman me fund të lumtur

BOTIMET TOENA

rat më të fshehta të shpirtit”. Drita, “e fejuara e damkosur e një armiku të klasës” dhe Selmani, më i arsimuar i zonës që s'pajtohej me qëndrimet staliniste të PPSH janë dy personazhet, marrëdhënia me të cilët, jo vetëm që nuk e zbehin, por përkundrazi e fisnikërojnë profilin e Nënës së B.Mustafajt.

SKANERI I NJË PARTIE QË NDËRHYNTE EDHE NË TRILLET E FSHEHTA DASHURORE

Me mjeshtri të rrallë artistike, me një guhë të pasur e mjete shprehëse interesante autori ekzaminon atë Parti që “kishte për detyrë të ndërhynte edhe në trillet e fshehta dashurore të anëtarëve të saj”, qoftë dhe duke përshkuar atë hallakatje të pavullnetshme ndër përhítje të nënës së tij që ruajti në shpirt një gjurmë të re malli për të shoqin komunist që Partia e kishte dërguar për studime në Tiranë. Ndaj dhe modeli i opingave artistike që i pari i Partisë së krahinës ia kishte porositur si “sekret shtetëror” do të ishte modeli që i përkiste vetëm një burri, që në këtë roman paraqitet si babai i autorit. Ato do të ishin opinga “më të bukurat e të bukurave”. Ndonëse sipas porositësit, masa e këmbës që do t'i vishte nuk kishte asnjë rëndësi, Nëna ishte zhytur në një makth nga i cili s'po dilte dot. E mundonte pyetja e tmerrshme për këmbën e burrit të mistershëm, këmbë e të cilit futet në çdo këpucë... “I tillë është vetëm djalli e i biri i djallit. Unë s'kam punë me të. Zot i madh m'ruaj mendtë në kokë!”. Ndaj dhe s'u besoi veshëve kur mësoi se opingat që kishte thurur ishin për Hrushovin që kishte zënë vendin e Stalinit në Moskë..Ndaj dhe i shpërtheu një e qeshur e vrullshme, e papërmbrashtme kur mësoi nga i Vjehrri se Hrushovi do të vishej me opinga si barinjtë e Tropojës! Në fillim ajo “nuk pati ndonjë lëndim në sedër si krijuesja e shpërfillur e dhurates simbolike për “babanë e popujve”, kur nuk e përfshinë në delegacionin që do të shkonte nga Tropoja në Tiranë për ta takuar atë. Por më pas kuptoja se “brenda saj rrithet pavetëdijshëm një përrua zemërimi, pse kërretë e Partisë në rrëth nuk e kishin marrë me vete në Tiranë”. Por gjithsesi, ato ditë kur pjesëmarrja në mitingje ishte e detyrueshme, prodhuesja e opingave artistike për Hrushovin do të shihte vehten dhe do të detyrohej të fliste në tribunën e mitingut të organizuar në qendrën e qytetit Bajram Curri. Dhe për sa kohë, tanët e patën mire me “babanë e popujve” Nëna, ndonëse e njihet fare pak politikën do të ishte më e preferuara e drejtuesvëe të saj në rrëth. Por rrjedha ndryshoi në të kundërtën, kur pas “tradhtisë” së Hrushovit, shoqja Rushe, si ziliqare që ishte do ta kërcënonte se tanë do t'i hapeshin petët lakorit, ç'ka nënkuqntone se Nëna (ose shoqja S e romanit) do të ndëshkohej si hrushoviste (ajo do të burgoset ndërsa do ta pësonë i shoqi komunist dhe tre djemtë e saj). Por autori, edhe në këtë rast ka meritën e përshkrimit të një Nënë që “krenohej me bukurinë e saj të jashtme, gjë që ishte e papajtueshme me vijën e partisë, sipas së cilës nuk ishte dukja, por thembi, domethënë bota e brendëshme, shpirti revolucionar që përbënte pasurinë dhe bukurinë e njeriut të ri”.

KOHERENCA ME REALITETIN OBJEKTIV

Nëse ngjarjet i përkasin kohës mënxyrë kur partia porosiste që lufta e klasave të zhvillohej edhe brenda

familjes, autori i sjell ato në koherencë me realitetin objektiv, qoftë edhe kur pohon “Udhëheqësit kishin një gjuhë të caktuar për të folur me njëri-tjetrin e një tjetër gjuhë për të folur me popullin”. (A nuk ndodh edhe sot kësisoj me klasën tonë politike të dalë boje?!?). Apo edhe kur pohon se ka gërmuar gjatë nëpër arkivat e Agjencisë Telegrafike Shqiptare për të gjetur fotografinë e nënës së tij në tribunën e mitingut të organizuar në Tropoje gjatë vizitës së Hrushovit në vendin tonë. Nga ai miting Nëna ishte dekoruar me “Urdhri i Yllit me Pesë Cepa” nga Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, dekoratë që do ta stresonte e mbante nën ankth gjatë gjithë viteve të mëvonshme pas “tradhtisë” së Hrushovit, kur mendonte se do t'i hapeshin një ditë petët lakorit! “Në të vërtetë – shkruan autori – ky arsyetim në kokën e Nënës sime do të sqarohej më vonë, ngadalë, gjatë përplasjeve të vështira që do të kishte ajo me veten për të ndarë sa më mirë nëse ishte viktimi, apo fajtore në këtë histori”. Është një histori e rrallë mbi të cilën autori ndërtur mjeshtërisht ngjarje e personazhe që na bëjmë të kuptojmë më së miri sistemin e kalbur të diktaturës komuniste. Ndonëse e përshkuar si hamendje të Nënës së tij, në të vërtetë është koha kur pas ngjarjesh e arrestimesh të bujshme për tradhti imaginare e kalime të paligjshme kufiri, qyteti Bajram Curri jetonte dita-ditës me një bombë me sahat në gj.

Shithurjen dhe dekadencën e atij sistemi autori na e paraqet mjaftë bukur qoftë dhe me profilizimin e personazhit të Vasiliqës, që ndonëse e kishte sjellë Partia të përhapte të renë e civilizimin në qytetin verior në zemër të maleve, qytetarët thonin: “Na qelbi vendin ajo bisht-përdredhura e dreqit!”. Dhe kur për këtë “bishtpërdredhurën” shkon fjala deri tek shoku Enver (nëpërmjet një letre anonime) se ajo “shkonte në shtrat jo vetëm me djemtë më të pashëm të qytetit, qofshin ata beqarë apo të martuar, por edhe me kuadrot e Partisë e të pushtetit, pa parë moshën e tyre, si dhe me oficerët e Sigurimit në rrëth”, Udhëheqësi do t'i kërcënonte ato se “puna e madhe dhe delikate e Partisë duhet përqëndruar kësaj here tërësisht tek burrat, për kalitjen e forcës së karakterit të tyre”. Autori që pohon se letrën anonime, bashkë me shënimin e Enver Hoxhës që e ka gjetur në Arkivën Qëndrore të Shtetit gjatë përgatitjeve për shkrimin e këtij romanit, argumenton më së miri për këtë “qëndrim krejt të përligjur të Enver Hoxhës që e kishte kuptuar më në fund se nuk kishte mënyrë tjetër veç anonomitat, për t'u varë njëzëve të thjeshtë leprurin e frikës, i cili me ata dhëmbët e tij prerës, po ia hante shpirtin popullit, siç hante lakrat natën në vjeshtë, në kopshitet e fshatarëve. Babai i atij lepuri të tmerrëshëm ishte hija e Stalinit”. Këtë tezë e mbron edhe me pohimin e Nënës së tij që i kishte pohuar se “hapi që bëri për t'u përfshirë në politikë, në të vërtetë e kishte hedhur në një greminë ku do të gjente një vetmi të ngulur si tumor i fshehtë, ngulitur në trurin e saj”.

ENIGMA PËR “KËPUCËN” ME TË CILËN HRUSHOVI GODITI TRIBUNËN E OKB-SË

Dhe si për ta përligjur këtë ngulitje, autori përshkuar më pas me realizëm ngulimin e Nënës që ai të gërmonte në Arkivin e OKB-së për këpucën më të cilën Hrushovi paskësh goditur tribunën e institucionit më të rëndësishëm botëror me pretekstin se nuk i kishin dhëni fjalën për një replikë rastësore. Autori nuk arrinte ta merrte dot me mend se çfarë lidhje shihte Nëna e tij midis opingave, që kishte bëri dikur për Hrushovin, dhe këpucës, më cilën kishte goditur ai tribunën e sallës plenare të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, siç ishte bëri e njohur botërisht dyzetepesë vjet më parë (12 tetor 1960)..., kur flitej për sherret e Hrushovit më kryetarin e asaj Asambleje, Frederick Boland-in, si dhe me kryetarin e delegacionit të Filipineve, një farë Lorenz Sumulong, i cili kishte thënë se popujt e Europës Lindore, të përpjëri nga Bashkimi Sovjetik, nuk gjëzonin të drejta civile e as politike.

Pikërisht kjo mungesë lirish të drejtash civile e politike si të drejtat bazë të lirisë njëzore përshkojnë si fill gjithë romanin “Dëmtuar gjatë rrugës” të Besnik Mustafajt. Ai e ka treguar mjaftë bukur në roman se çfarë e bëri Nënët të ketë aq frikë nga zyrat e pushtetit. “Nëna” në romanin tim nuk është një personazh që e bën politikën. Ajo vetëm e pëson politikën. Rrjedhimisht, përjetimet e saj janë ato të një personazhi të pafuqishëm përballe politikës. Vetëdija e pafuqisë është dërrmuese për njeriun. Në këtë roman unë kam synuar ta tregoj ekzistencën e shqiptarit të thjesht nën

reçensa

Të gjithë me Durrësin, me Tiranën, me Thumanën

(Vijon nga faqja 1)

pushton shpirtin, pushton ndërgjegjen e gjithë atyre që mendojnë përgjegjshëm. Kjo është tronditje në të cilën përmblidhen ndjenja e mendime për historinë, për bashkëkohësinë dhe për ardhmërinë tonë, por edhe për historinë, bashkëkohësinë, ardhmërinë në përgjithësi. Kjo tronditje na nxit të vëtëpyetemi:

A kemi mësuar krejt çka duhej prej historisë?

A e kemi vështruar dhe kuptuar sa e si duhet bashkëkohësinë?

A kemi menduar largpashëm për ardhmërinë?

2.

Në këto gjendje tronditjesh mund të jesh i pushtuar edhe prej mendimesh kundër natyrës dhe me mendime të tilla të drejtoshesh asaj:

Natyrë! Natyrë e mrekullueshme në këtë planet që i thonë Tokë, Tokë me bukur të jashtëzakonshme që nuk mund të merren me mend në asnjë planet a trup tjetër qiellor. Na e ke bërë të mundshme jetën në hapësirat tua tokësore, ujore e ajrore.

Pse kohë pas kohe po na e helmon jetën edhe me tragedji, me tronditje, me pikëllime. Përpos prej njerëzve, popujve, shteteve, fatkeqësítë, tronditjet po na vijnë edhe prej teje, Natyrë!

Dhe po na vijnë me padrejtësi.


Hajde e mos i shpreh këto mendime kur i sheh arkivolet e dëgjon fjalët e medieve për tragjeditë që u mbyllën në ato arkivole:

Për tragjeditë e familjes Lala, të cilën e përbënte edhe Nëna me katër fëmijët, mes të cilëve binjakët dyvjeçarë, ndoshta ende duke u mëkuar nga qumështi i nënës. Asnjë fjalë, asnjë figurë, asnjë mendim, asnjë pamje nuk është e mjaftueshme për të përshkruar, për të paraqitur gjithë tronditjen që na shkaktoi pamëshira tragjike me të cilën natyra e dënoi këtë nënë me katër fëmijët e saj, me binjakët e saj! Dhe të tjerët bashkëviktima me ta. Hajde e mos i shpreh këto mendime kur i sheh arkivolet në të cilat u mbyllën tragjeditë e anëtarëve të familjeve Cara, Ndreu, Gregu, Vata, Reçi, Mecja. E të tjera, tragjeditë e të cilave na e copëtojnë zemrën.

Hajde mos i shpreh këto mendime kur i sheh arkivolet e dy vëllezërvë kosovarë, Abazi, të valltares, të piktores, të studentes që donte të studionte arkitekturën e bëhej mjeke, të të rinjve të tjerë e të reja të tjera që nuk priten të provojnë të mirat e gjëzimet që sjell pjekuria!

Por, hajde e mos e thuaj edhe një mendim tjetër që kë krejt nuk do e nge kundër shqiptuesit të këtij mendimi: tronditjes që na ka pushtuar i kanë kontribuar disa njerëz, disa nga ata njerëz të zgjedhur gjatë 30 vjetëve tona për të krijuar institucionet e për të ngritur ekspertët që do të merreshin me të priturat e me të papriturat që mund të na sillte kur natyra e pamëshirshme e kur njëmëndësia e keqkuptuar.

Dhe, këta njerëz i quajmë politikanë



e shtetarë!

3.

Në këto ditë tronditjesh unë nuk mund të mos mendoj edhe për ato që kam parë e kam dëgjuar që tridhjetë vjet në jetën partake, politike, shtetërore shqiptare. E ato që dëgjoja dhe ato që shihja gjatë njëzet e katër orëve të ditës e të natës ishin e janë mosmarrëveshjet, zënkat, konfliktet, mosdurimet, urrejtjet e ndërsjella të forcave politike, në radhë të parë të prijësve politikë dhe të argatëve të tyre.

Deri në ditën e tërmetit tragjik nuk gjendej arsy, nuk gjendej mjet, nuk gjendej qëllim kombëtar, shoqëror, shtetëror o moral, më në fund njerëzor, që prijësht partikak e shtetërorë të këtyre tridhjetë vjetëve do t'i bënte e do t'i debyronte, më në fund, të merreshin vesh. Jo.

E mosmarrëveshjet e tyre, mosdurimet e tyre, zënkat e tyre, konfliket e tyre, privileget e tyre dhe lukset e tyre janë ndërsa arsyet e degdishes së gati dy milionë shqiptarëve nga Shqipëria e Kosova në Botë gjatë 10-15 vjetëve të fundit!

Tani, përnjëherë, pas tërmetit, pas fatkeqësise natyrore, u pajtuan: gjatë atë që as këta e as ata paraardhësit e tyre nuk e gjenin kurrsesi më parë: u pajtuan!

Dhe, ai, kryetari partiaq që që sa vjet në Shqipëri, në Kosovë, në Ballkan, në Evropë e në SHBA flet vetëm për më të këqijat, më të ulëtat, më të poshtrat, më të zezat, më të krimshmet e Shqipërisë në politikën e atyre ndaj të cilëve është në opozitë, përnjëherë tha: me gjithë ndasitë që kemi, në nevojë jemi një komb! Por, Por!

Mendja e tij na mësoi se vetëm në nevojë, e jo edhe në tragedji, vetëm në nevojë e jo edhe në gjëzime, në nevojë e jo edhe në varfëri, jemi komb, jemi një komb!

Dhe kjo fjali megjithatë shumë shpejt u botua në rrjetet sociale të kundërshtarit politik – të të sulmuarit pa pushim shumëvjeçar!

Dhe, kështu u pajtuan! I pajtoi tragedia e të varfërvë! I pajtoi tragedia e të shpërfillurve. I pajtoi tragedia e të konsideruarve të tepërt! Por u pajtuan rre-

jshëm.

Mund të them siç po them se pikërisht tani kur këta rreshta po i qes në shkrimit po dëgjoj sulmet e dy Sulmuesve të pandalshëm ndaj të Sulmuarit të gjithnjëshëm – kryeministrat Edi Rama! Dhe, po i shoh Sulmuesit duke u sjellë ndaj pasojave tragjike të tërmetit si qeveri e dytë e Shqipërisë, që e shpërfill, s'pronon Qeverinë që zgjodhi populli! Dhe, Shqipëria e Abdyl Frashërit, Vaso Pashës e Ismail Qemalit na bëhet Shqipëri me dy qeveri të papajtueshmë në ditët paskajshëm pikëlluese, tronditëse në historinë e saj.

4.

Dua të shpresoj, dua të besoj se pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019 populli shqiptar do të jetë forcë politike me sy, me të cilët do të shohë më qartë se deri tash, forcë politike që e sheh qartë, që e kupton qartë gjendjen e vet, që e mendon qartë ardhmërinë e pasardhësve të vet, që mendon jo vetëm për premtimet e të priturat, si deri tanë, por edhe për të papriturat natyrore, politike, shtetërore.

Njëmëndësia aq e pritur, aq e ndërruar, aq e dëshiruar na ka sjellë edhe shumë të papritura e shumë dëshpërime gjatë këtyre tridhjetë vjetëve. NA e solli edhe "qeverinë" e dytë në ditët më dhembjesjellëse!

Por, nuk jam pesimist.

Pesimist nuk mund të më bëjnë ata që postet politike i shfrytëzojnë për t'u qëndisur me miliona duke shfrytëzuar postet politike, ata që postet politike i shfrytëzojnë për t'u stolisur me vila në Gjirin e Lalzit e përgjatë bregdetit, në Brezovicë e Prevallë. Dhe jo vetëm. Jo. Kurrë. Pas tronditjes sado e gjatë qoftë, që solli tërmeti, fatkeqësia, megjithatë, do të bëhet nxitje për forcim, për ngritje shpëtërore, etike, shoqërore, kombëtare, shtetërore. Populli shqiptar, përpos gjatë këtyre tridhjetë vjetëve tranzicion, kurë, në asnjë epokë a periudhë historike, nuk ishte pa figura historike si Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, Jeronim De Rada, Konstandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Hoxha Tahsini, Jani Vreto, Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, Naim Frashëri, Luigi Gurakuqi, Hasan Prishtina, Isa Boletini, që politikë e përdorën jo duke u pasuruar prej saj po duke u fljuar për

11 - DHJETOR 2019 - JANAR 2020

Në këto ditë tronditjesh unë nuk mund të mos mendoj edhe për ato që kam parë e kam dëgjuar që tridhjetë vjet në jetën partake, politike, shtetërore shqiptare.

Nderimi për ata që shpëtojnë jetë njerëzish

Mirënjojja, si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, merr dimensione të reja kur u adresohet atyre që shpëtojnë jetë njerëzish. Veçanërisht në këto ditë të kobshme për kombin shqiptar, pas tragedjisë që shkaktoi tërmeti apokaliptik me magnitudë 6.4 i shkallës Rihter, mesnatën e 26 nëntorit, që u mori jetën 50 njerëzve, mirënjojja u adresohet të gjitha atyre që kontribuuani në nxjerjen e trupave të tyre nga gërmadhat dhe në shpëtimin e qindra të tjerëve. Dhe nuk qenë të paktë ata që kontribuuani në lehtësimin e dhimbjeve e pikëllimit mbarëshqiptar.

Ndaj, edhe të premten në darkë, më 29 Nëntor (ditën e jubileut të lavdishëm të 75-Vjetorit të Çlirimtë Atdheut), pas katër ditë kërkimi intensiv, gjeneral brigadë, Manushaqe Shehu, në funksion si zëvendësshefi Shtabitë Përgjithshëm të Forcave tona të Armatosura nderoi me Certifikata Mirënjojje ekipin kosovar të kërkim-shpëtimit, të kryesuar nga Kapiten Kreshnik Nimani. "Mirënjojja, si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut është më kuptimplotë në këto ditë të vështira për të gjithë ne. Ajo ju takon Ju që si ekip kosovar erdhët të parët dhe dhatë një kontribut të veçantë në shpëtimin e disa të jetëve dhe në nxjerjen e disa të pajetëve nga gërmadhat. Në këto ditë të vështira, Ju u bëtë shembull frysëzimi edhe për forcat tona të armatosura", u shpreh ndër të tjera numri dy i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Vetë gjeneral Brigade, Manushaqe Shehu, e vërtja grua shqiptare me këtë gradë madhore dhe në një funksion kaq të rëndësishëm, ishte bashkë me ekipin kosovar në ndihmë të personave që u ndodhën nën rrënoja, si pasojë e tërmetit që shkatëroi një qytetë të tjerë në Thumanë, ku mori jetën e 24 personave (24 viktima të tjera në Durrës dhe 2 në Kurbin) dhe shkatëroi dhjetë pallate e shtëpi baruni. Në përfundim të këtij misioni, ajo i falenderon përzemërshtet dhe shpreh mirënjojje për heronjët e këtyre ditëve të paharrueshme dhimboje kombëtarë.

Shqipërinë e për shqiptarët. Durrësi, më i dëmtuari në tërmetin e 26 nëntorit, do ta marrë veten. Shumë tërmete ka përfjetuar Durrësi: më 177 para erës sonë, më 334, 506, 1273, 1869, 1870, 1926, 1979... dhe shpejt e ka marrë veten. Ishte qytet i dëshiruar edhe prej të huajve, prej miqve dhe prej pushtuesve. Takimet me popuj të tjerë e kanë pasuruar kulturën e tij e qytetërimin e tij dhe e kanë shtuar lavdinë e tij historike e kombëtarë. Fatkeqësinë e fundit natyrore, si edhe herët e tjerë, Durrësi do ta përballojë, do ta mundë me dhuntinë e tij të madhe jetëkrijuese, gjallëruese ndërtimore e gjithëkombëtarë.

Në sajë të dhunitive të Durrësit, në sajë të solidarësisë që treguan bashkëdhatarët kudo që janë sot e, sidomos, Kosova, shqiptarët e goditur prej tërmetit do të kenë gatishmëri e do të dinë të zbatojnë mësimet e rilindësve të mëdhenj të cilët me gjithë sakrificat e pamatshme e bënë Shqipërinë dhe e bënë shqiptarin: më të fortë, më të ngritur e më të zhvilluar në të gjitha pikëpamjet.

Fatkeqësia e 26 nëntorit do të përfundojë me fuqizim të përgjithshëm të shqiptarëve: të mundësive ndërtuese e krijuar.

E kuptueshme. Nuk është thënë pa dëshmi shumëshekullore se dhembjet e vuajtjet i bashkojnë njerëzit më shumë se gjëzimet.

E tani për tani më e rëndësishmja është: të jemi – të gjithë me Durrësin, me Tiranën, me Thumanën e të gjitha qytetet, qytetat, fshatrat që e dëmtoi tërmeti, të jemi me ta me çka kemi, me çka mundemi e me çka dimë. Se ashtu do të jemi me shtetin amë, Shqipërinë, me Kosovën, me gjithë bashkëkombëtarët kudo ndodhen ata.

Një palë opinga për Hrushovin?!

(Vijon nga faqja 10)

diktaturë jo duke e kërkuar dramën në vatrën e dukshme të dhunës e që ishin burgjet apo internimet, por në atë pjesë të skenës që paraqitej si suksesi i regjimit e ku jetonte shumica absolute e popullsisë", -shprehet Mustafaj. Pikë-

isht pse ai arrin ta qartësojë Nënën për këtë realitet të trishtë, apo edhe për pakon e ardhur pas shumë vitesh nga Munihu me shënimin e postës së Tiranës "Dëmtuar rrugës", ky, mund të konsiderohet vërtetë një roman me fund të lumtur. Pas arritjes me këtë roman të llojit dhe stilit të veçantë,

Besnik Mustafaj është në të drejtën e tij të lëjë mënjanë politikën dhe t'i përkushtohet totalisht me gjithë potencialin e talentit te tij prozes. Pasi është vërtetë besafues prezantimi i tij i fundit me këtë roman fitues të Çmimit të madh të Panairit të Librit 2019 dhe me të cilin ai u shpall "Autori më i mirë i vitit". ---

Kam zgjedh' të iki tutje, larg,
Largësia ime për ty është e trishtë;
Si dritë në sy përtetë të kam,
Lot i mërzitur, thyer në shpirt.

DEMIR RUSI

Tërmeti dhe shteti



Zia kombëtare vendin mbuloj!
Forca e natyrës na shkatërron;
Ndodhin gjithandej, kjo nuk të fal,
Sështë në dorën tonë, t'i themi ndal.

Por tek ne është paksa ndryshe,
Se punohet me allishverishe;
Mu në buzë të detit, bash e në ranë
Ndërtohen masive pallatesh të tanë.

Leje pa kriter, kujt' mundet, jepi..
Mjafton të parit t'i mbushet xhepi;
Ndërtuesi siç do, punën vazhdon;
Shteti po vodhi dot s'kontrollon.

Në fund krejt kot, bëjnë koalidime,
Në fakt bëjnë hesapet përfitme;
Mbush formularë, zbukuron fasadat
Dhe vjen një ditë, shemben pallatet.

Dhe qajnë, gjasmë me lot krokodili,
Ministra deputetë e vet kryeministri;
Thonë, s'kemi ç'bëjmë?! Natyra, tërmeti?!

Jemi mes jush, me ju është shteti!!!

Unë vet, përgjatë Durrësit kalova,
Me tagrin e moralit, si qytetar shkova;
Gjykoj me bindje: s'ka faj tërmeti,
Se shkilen kriteret e rregullat nga shteti...

T'më fali, kush shtetin don ta mbrojë,
Por askush nuk mund ta justifikojë;
Kaluan dekada, të gjithë me rradhë
E çmenden kët' popull, e bënë rrumpallë.

Dhe vjen një ditë, mbushim varret...
Me njerëzit e varfér, të mbetur nga hallet
Ata që ndoshta dhe me buk s'i ngopët,
Vdiqën me tmerr, nga shteti i dobët...

TMERR NË DURRES E TIRANË

Tmerr! Tërmet në Durrës, Thumanë e Tiranë.
Vdiqën shumë të pafajshëm nën gërmadhë;
Solidariteti mes njerëzve, i paparë
Dhe kafsha për të zotin duke qarë!

Unë për qenin kam shumë debulesë,
Është qenia më e ndjeshme e me besë;
Shikoni miq, a nuk ju dhimbset,
Qeni të zotit nuk i shqitet....

Burri nën gurë kërkon ndihmë,
Qeni sinjalizon me ulërimë...
Këmbën mbi dorën e t'zotit,
Lutet e qan me pikë të lotit!

Ndale dorën o Zot, me kaq lëre,
Sot krejt të çmendur na bëre!
Kudo shikon njerëz të përlotur;
Qajnë viktimat e plot të plagosur....



BARIE ÇUPI

TE IKI LARG

Kam zgjedh' të iki tutje, larg,
Largësia ime për ty është e trishtë;
Si dritë në sy përtetë të kam,
Lot i mërzitur, thyer në shpirt.

Po si të rri teje larguar?
Çasti më i bukur tek ti më sjell
i vetmi yll ndezur, gezuar...
Buzeqeshur sikur diell.

Dhe të gjurmoj ashtu hutuar,
Perkalem ty, dhe pse jam larg;
Bej se po iki, por jam afruar,
Të të ndiej, më duket pak.

Duhet të iki, s'kam rrugë tjetër,
Të iki larg, mos jem rikthim!
Ç'ka kam marrë, ka mbet në zemër,
Malli më i ëmbël në çdo kujtim...

PËRGJOJ DIELLIN T'MË THAJ TRISHTIMIN....

Jam shumë e mrzitur!
Do të shkruaj sonte përvete;
Buza më dridhet e drobitur,
S'ia kuptova dot hilet ksaj jete.

Fryma më merret,
Nuk munda të urrej as dje, as sot;
Drita brenda meje zhënjehet
E digjet në turrën e drurëve pa lot.

Heshtjen e kam të rendë,
Do të shkruaj këto fjalë e lodhur;
Vitet më vallëzojnë në pëllëmbë,
Buzëqeshja rri nën hije,
pangopur.....

Ju s'mi kuptuat vdekjet,
Më përcmuat brengën dhe hënën
ma qasët!
Pranvera kur qau nga rrekjet,
Ëndrrat lëvizën përflikur
por ngathët.....

Jam plagosur në çdo qelizë,
E nuk di ta var kokën asnjëherë;
Harroj e prap i dua të gjithë...
Me gjunjë të këputur
e të prerë....

Jam unë e rrënuar
në këtë poezi,
Shtypur pabesish besimin;
Gjithçka si një hiç në gjithësi..
Sërisht zvarritem e duruar,
Përgjoj diellin t'më thajë
trishtimin....

RETE PAS

Shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme

Një program i rezervuar
dhe personalizuar për
qytetarët shqiptarë për
të hyrë në shërbime
shëndetësore me cilësi të
lartë dhe çmime të për-
ballueshme.



FIRENZE RETE PAS, GARANTON: Shërbime shëndetësore në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese; Një rrjet ambulatori iali përbërë nga 11 qëndra në territorin e Firences dhe me një mesatare prej 20,000 hyrje në muaj.

Shërbim i shpejtë pa kohëpritje.

Komunikimi mundsohet nga përkthyes të specializuar në këtë fushë

NDËR SPECIALITETET QË NE OFROJMË JANË

- Alergologjia, Angiologji, Kardiologji, Kirurgji, Dietologji, Dermatologji, Ecografi, Endokrinologji, Gastroenterologji, Gjinekologji, Gjeriatri, Neurologji, Nefrologji, Okulistika, Ortopedia, Osteopatia, Otorinolaringologji, Pediatria, Pneumologji, Psikiatri

RETE PAS ofron shërbime shëndetësore me tarifa të përballueshme për të gjithë, me një ekip mjekësh italianë me aftësi të larta, veçanërisht në fushën e diagnostikimit:

- radiologji,
- resonance magnetike, tac -

Mamografi dhe tomosintezë, -

ekografi ... me përdorimin e pajisjeve te avancuar për rindërtimin e imazheve volumetrike, në tredimensione (siç është për tomosintezën e gjirit).

ORGANIZOJME GJITHÇKA ne kohen që ju ose i afermi juaj do asistohen/ni ne strukturatona. • Shoqerimi ne cdo vizite e pacientit me perkthyes shqipëtar.

Per informacione dhe prenotime na \kontaktoni: Email: age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580

WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)

Organizojmë gjithçka në kohën që ju ose I afermi juaj do asistohen/ni në strukturatona. • Shoqerimi në çdo vizitë e pacientit me perkthyes shqiptar.

Për informacione dhe prenotime na kontaktoni: Email age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580 WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)